


**UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY**



**FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW**

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**HEQJA E TË DREJTËS PRINDORE NË SISTEMIN JURIDIK TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

MENTORE:

Prof. Dr. Emine Zendeli

KANDIDATE:

Adelina Halili

Tetovë, 2017

Dhe në fund, jo se është më pak e rëndësishme, por është e jashtëzakonshme, andaj desha ta theksoj më shumë falënderimin tim ndaj Zotit, që më fali shëndet, më fali dashuri ndaj kërkimit të diturisë dhe veçanërisht që më fali një familje kaq të veçantë për mua, të cilët më kanë dhënë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre të pakursyer në të gjitha sfidat e mia gjatë studimeve.

Ka qenë familja ajo e cila më ka përmbajtur dhe forcuar gjatë gjithë rënieve dhe ngritjeve të mia jetësore, andaj në këtë rast të veçantë për mua, dua t'ju shpreh mirënjohjet e mia të përzemërta dhe

Ju Falemnderit që ishit vazhdimisht me mua.

Vajza juaj Adelina.

STRUKTURIMI I PUNIMIT

Hyrje	5
Kapitulli i parë e drejta prindore	6
1. KUPTIMI I TË DREJTËS PRINDORE	6
2. PËRMBAJTJA E SË DREJTËS PRINDORE	6
3. OBJEKTI I SË DREJTËS PRINDORE	7
4. SUBJEKTET E SË DREJTËS PRINDORE	7
5. PARIMET E SË DREJTËS PRINDORE	8
6. THEMELIMI I MARRËDHËNIEVE MIDIS PRINDËRVE DHE FËMIJËVE	9
6.1. Vërtetimi i atësisë dhe amësisë	9
6.2. Kontestimi i atësisë dhe amësisë	11
7. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PRINDËRVE NDAJ FËMIJËVE	12
Kapitulli i dytë ushtrimi i të drejtës prindore	19
1. MBIQYRJA E USHTRIMIT TË SË DREJTËS PRINDORE	19
2. MËNYRAT E USHTRIMIT TË SË DREJTËS PRINDORE	20
3. PEZULLIMI I TË DREJTËS PRINDORE	22
4. KUFIZIMI I SË DREJTËS PRINDORE	23
5. PUSHIMI I SË DREJTËS PRINDORE	25
6. VAZHDIMI I TË DREJTËS PRINDORE	26
7. HEQJA E TË DREJTËS PRINDORE	29
7.1 shkaqet e heqjes së të drejtës prindore	31
7.2 pasqyra historike për heqjen e të drejtës prindore në të drejtën romake	37
7.3 pasqyra historike për heqjen e të drejtës prindore në të drejtën zakonore shqiptare ...	40
Kapitulli i tretë procedura për heqjen e të drejtës prindore	42
1. OBJEKTI I PROCEDURËS	42
2. KOMPETENCA VENDORE E GJYKATAVE	43
3. INICIMI I PROCEDURËS	43
4. ZHVILLIMI I PROCEDURËS	44
5. AKTVENDIMI	46

6.	NATYRA JURIDIKE DHE EFEKTI I VENDIMIT	47
7.	MJETET JURIDIKE.....	47
8.	SHPENZIMET NË PROCEDURË	48
9.	PASOJAT E HEQJES SË TË DREJTËS PRINDORE	48
10.	PËRCAKTIMI I PRINDËRVE NË POZITËN E KUJDESTARIT	48
11.	KTHIMI I TË DREJTËS PRINDORE	48
1.	HEQJA E TË DREJTËS PRINDORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	50
	1.1 ligji për familje në republikën e kosovës.....	50
	1.2 komparacioni në mes ligjit për familje në republikën e kosovës dhe të maqedonisë sa i përket heqjes së të drejtës prindore	50
2.	HEQJA E TË DREJTËS PRINDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.....	52
	2.1 kodi për familje në republikën e shqipërisë	52
3.	HEQJA E TË DREJTËS PRINDORE NË REPUBLIKËN E SËRBIË	53
	3.2 komparacioni në mes ligjit për familje në republikën e sërbië dhe të maqedonisë sa i përket heqjes së të drejtës prindore	53
	PËRFUNDIMI DHE KONKLZIONI	55
	BIBLIOGRAFIA	56

HYRJE

Sipas dispozitave të nenit 40 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë shoqërore të organizuar nga ana e shtetit, në këtë kontekst, prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Gjithnjë në këtë frymë, Republika u siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve, të cilët për çfarëdo arsye kanë ngelur pa kujdes prindëror.

Kujdesi ndaj fëmijëve konsiderohet si interes parësor në çdo familje dhe në çdo shoqëri bashkëkohore. Fillimisht, duke pasur parasysh lidhjen specifike që egziston ndërmjet prindërve dhe fëmijëve është detyrë e prindërve që të kujdesen për fëmijët e tyre të mitur. Mirëpo, duke qenë të ndërgjegjshëm se fëmijët janë kategoria më e ndijshme e shoqërisë, dhe se ato janë ardhmëria e një shoqërie, shteti dhe shoqëria janë të interesuar që kjo kategori e rëndësishme e shoqërisë të gëzojë përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë jo vetëm brenda kornizave të familjes por edhe nga ana e organeve kompetente dhe gjykatave, sidomos në rastet kur prindi keqpërdor të drejtën prindore, ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose ndikon negativisht në edukimin e fëmijës me veprimet e tij. Edhe pse asnjë autoritet nuk mund të zëvendësojë ngrohtësinë prindore, rritjen dhe edukimin në një ambient familjar, në rastet e lartpërmendura vjen në shprehje ndërhyrja e organit kompetent dhe prindit i hiqet e drejta prindore me vendim gjyqësor.

E shoh të arsyeshme të bëj një hulumtim të tillë pasi që sado që heqja e të drejtës prindore objektivisht mund të tingëllojë si ndërmarrje e një veprimi të thjeshtë procedural, në esencë një vendim i tillë është i lidhur ngushtë me aspektin emocional të lidhjes së prindërve me fëmijët. Edhe pse me vendimin për heqjen e së drejtës prindore në çdo rast shiqohet interesi më i mirë i fëmijës, nuk është aspak e lehtë ndarja e tyre, përkundrazi është prekesë.

KAPITULLI I PARË

E DREJTA PRINDORE

1. Kuptimi i të drejtës prindore

Të drejtën prindore e përbëjnë të drejtat dhe obligimet e prindërve për tu përkujdesur për personalitetin, të drejtat dhe interes të fëmijëve të tyre të mitur dhe fëmijëve mbi të cilët ka vazhduar e drejta prindore.¹

Të drejtën prindore mund ta kuptojmë si:

- a) Pjesë përbërëse e të drejtës pozitive familjare;
- b) Pjesë përbërëse e shkencës juridike.

E drejta prindore si pjesë përbërëse e të drejtës pozitive familjare i përfshin të gjitha dispozitat ligjore pozitive me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, si dhe marrëdhëniet midis personave të tjerë në gjini.

E drejta prindore si pjesë përbërëse e shkencës juridike mbi të drejtën familjare përfshin tërësinë e studimeve që i referohen rregullimit juridik të marrëdhënieve midis prindërve e fëmijëve, si dhe marrëdhënieve midis presonave të tjerë në gjini.²

Ekzistojnë dilema rreth termit “e drejtë prindore” si dhe “marrëdhënie prindore”. Marrëdhëniet prindore zakonisht krijohen me lindjen e fëmijëve si dhe me adoptimin e tyre, pra në rrugë juridike. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve krijohen prej momentit kur krijohen marrëdhëniet prindore. Nga këtu kuptojmë se marrëdhëniet prindore janë të karakterit të përhershëm dhe përfundojnë me vdekje, të prindit ose të fëmijës. Ndërsa e drejta prindore si e drejtë subjektive, zgjat deri sa fëmiju të arrijë moshën madhore.³

2. Përmbajtja e së drejtës prindore

Përmbajtja e të drejtës prindore përbëhet nga të gjitha të drejtat dhe detyrat që dalin nga prindërit në raport me fëmijët e tyre. Këtu bëjnë pjesë mirëritja, edukimi, arsimimi,

¹ Neni 44, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.38/2004

² Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, E drejta familjare, 2007 Prishtinë, faqe 199

³ Spiroviq-Tërpenovska Liljana, Semejno pravo, 1997 Shkup, faqe 146

përfaqësimi ligjor si dhe administrimi i pasurisë së të miturit. Fëmijët e gëzojnë mëshitetjen morale dhe materiale nga ana e prindërve deri sa të arrijnë moshën madhore dhe të gjithë këto përbërës të kësaj mbështetje e përbëjnë të drejtën prindore.⁴

3. Objekti i së drejtës prindore

Objekt i së drejtës prindore janë marrëdhëniet të cilat krijohen mes prindërve dhe fëmijëve, e gjithashtu këtu përfshihen edhe marrëdhëniet mes personave të tjerë në gjini. Pra, e drejta prindore rregullon marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve, si ato të prindërve që janë në marrëdhënie martesore, ashtu edhe të atyre prindërve në marrëdhënie jashtëmartesore, rregullon marrëdhëniet mes adoptuesit dhe të adoptuarit, statusin e fëmijëve të legjitimuar, si dhe marrëdhëniet mes kushërinjëve të tjerë.⁵

Thënë më ndryshe si objekt i të drejtës prindore paraqitet rregullimi i marrëdhënieve mes prindërve dhe fëmijëve, të drejtat dhe detyrimet mes prindërve dhe fëmijëve si dhe mes personave të tjerë të familjes, ushtrimi i të drejtave dhe detyrave prindore, si edhe përfundimi dhe vazhdimi i të drejtës prindore.⁶

4. Subjektet e së drejtës prindore

Si *subjekte* të së drejtës prindore paraqiten: *prindërit* dhe *fëmijët*.

Prindër të fëmijës janë nëna dhe babai (i ati). Nëna është gruaja që e ka lindur fëmijën, ndërsa babai është burri i nënës së fëmijës, ose burri me të cilin është zënë fëmija. Pra, baba i fëmijës martesorë konsiderohet burri i nënës së fëmijës në qoftë se fëmija ka lindur gjatë martesës ose brenda afatit prej 300 ditëve pas mbarimit të martesës. Ndërsa për fëmijët jashtëmartesorë baba i fëmijës konsiderohet burri që e pranon fëmijën për të vetin ose ai, atësia e të cilit vërtetohet me vendimin e gjykatës.

Fëmijë konsiderohen personat fizik të cilët ende nuk e kanë arritur moshën madhore. Nën këtë moshë, personat fizik llogariten si persona të mitur dhe në këtë rast nuk kanë zotësi të plotë të veprimit, prandaj në raporte juridike i përfaqësojnë prindërit e tyre. Pra, prindërit janë përfaqësues ligjor të tyre, përveç se në rastet kur fëmijët nuk kanë prindër ose në rastet kur prindërve u është hequr e drejta prindore dhe përfaqësues ligjor është kujdestari.⁷

⁴ Mandro-Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tefta dhe Fullani Arjana, E drejta familjare, 2006 Tiranë, faqe 577

⁵ Oruçi Gani, E drejta familjare, 1994 Prishtinë, faqe 122

⁶ Haxhivasilev Mile, Semejno pravo, 1987 Shkup, faqe 235

⁷ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 200

Edhe në Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës, neni 1 thotë: “Me fjalën fëmijë nënkuptohet çdo njeri nën moshën 18 vjeçe, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.”

5. Parimet e së drejtës prindore

Në teori të ndryshme juridike i hasim këto parime të së drejtës prindor: parimi i interesit më të lartë të fëmijës; parimi i barazisë së prindërve në ushtrimin e të drejtës prindore; parimi i barazimit të fëmijëve; si dhe parimi i reciprocitetit.

a) Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

Ky parim nënkupton vendimet e autoriteteve kompetente si dhe të prindërve lidhur me atribuimin e të drejtës prindore apo mënyrën se si duhet të ushtrohet e drejta prindore në mënyrë që t'i përshtatet interesave të fëmijës.

b) Parimi i barazisë së prindërve në ushtrimin e të drejtës prindore

Ky parim ka të bëjë me atë se si prindërit kundrejt njëri tjetrit, ashtu edhe autoritetet duhet të respektojnë barazinë mes tyre dhe se nuk duhet të bëjnë asnjë diskriminim për shkak të gjinisë, racës, gjuhës, besimit, pasurisë, shtetësisë, arsimimit, e kështu me rradhë. Ky parim ka për qëllim që të realizohet interesi më i lartë i fëmijës dhe njëkohësisht të vendosen barrier ndaj diskriminimit të gruas apo në këtë rast nënës së fëmijës.

c) Parimi i barazimit të fëmijëve

Ky parim do të thotë që qoftë fëmijët martesorë, qoftë fëmijët jashtë martesorë apo qoftë ato të adoptuar duhet të jenë të barabartë.

d) Parimi i reciprocitetit

Ky parim nënkupton respektin, dashurinë dhe ndihmën reciproke që duhet të mbizotërojnë gjatë ushtrimit të së drejtës prindore, tek marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve.⁸

⁸ Mandro-Bilalli Arta, E drejta familjare, 2007 Tiranë, faqe 404

6. Themelimi i marrëdhënieve midis prindërve dhe fëmijëve

6.1. Vërtetimi i atësisë dhe amësisë

Lindja e fëmijës nënkupton origjinën e tij nga nëna dhe i ati, por ka shumë rëndësi fakti nëse fëmija ka lindur nga prindër të cilët janë në martesë ose nga prindër të cilët nuk janë në martesë. Për fëmijën e lindur në martesë përcaktimi i amësisë dhe atësisë janë të lidhura me faktin juridik të lindjes së tij si dhe me prezumimet ligjore, të cilat e kanë bazën në lidhjen martesore të prindërve të tij. Nga kjo që thamë, mund të paraqesim tre elemente të rëndësishme :

- Në kuadër të përcaktimit të amësisë dhe atësisë së fëmijës evidentohet akti i lindjes si një akt administrativ;
- Përcaktohet se amësia dhe atësia e një fëmije të lindur nga martesa, në kuptimin ligjor janë vetëm ato që shënohen në aktin e lindjes;
- Akti i lindjes përbën një akt me vlera të plota vetëm kur është regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.⁹

Nënë e fëmijës konsiderohet gruaja e cila e ka lindur fëmijën dhe ajo regjistrohet në librin amë të të lindurve. Amësia e fëmijës është gjithëmonë e njohur.¹⁰

Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, në nenin 50 thotë: “Bashkëshorti i nënës konsiderohet baba i fëmijës së lindur gjatë kohëzgjatjes së martesës ose në afat prej 300 ditëve pas pushimit të martesës.” Ndërsa, sa i përket bashkëshortëve jashtëmartesor, neni 51 po i këtij ligji thotë: “Si baba i fëmijës së lindur jashtë martese konsiderohet personi që fëmijën do ta njohë si të tijin.”

Si baba të fëmijës që ka lindur nga prindërit jashtëmartesor, neni 61 i ligjit për familje të RM-së e konsideron: “Si baba i fëmijës së lindur jashtë martese, do të llogaritet personi që me nënën e fëmijës ka pasur marrëdhënie intime në afat së paku 180 deri më 300 ditë para lindjes së fëmijës, përderisa nuk provohet e kundërta. Gjatë vërtetimit të atësisë, gjykata i merr parasyshë veçanërisht edhe jetën e përbashkët dhe marrëdhëniet e ndërsjella të nënës së fëmijës dhe të paditurit para dhe pas lindjes së fëmijës, si edhe dëshmitë e tjera mjekësore të cilat nuk përjashtojnë të paditurin si baba i fëmijës.”

Mirëpo, për shkak të mënyrave të ndryshme të zënies së fëmijës, sidomos mënyrës artificiale, supozimi se “burri i nënës së fëmijës është baba i fëmijës” bëhet më i ndërlikuar. Në këtë rast duhet të dallojmë dy raste: 1) kur zënia e fëmijës është bërë në mënyrë artificiale me qelizat e burrit të nënës së fëmijës, si dhe 2) kur zënia e fëmijës është bërë në mënyrë artificiale

⁹ Mandro-Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tefta dhe Fullani Arjana, Vepër e cituar, faqe 508

¹⁰ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 202

me qelizat e një burri tjetër. Në rastin e parë, edhe pse zënia është bërë në mënyrë artificiale, nuk ka arsye për tu kundërshtuar atësia. Ndërsa në rastin e dytë, baba biologjik nuk është burri i nënës së fëmijës, por burri nga i cili është marrë qeliza për zënieën e fëmijës, kurse burri i nënës së fëmijës është baba social i fëmijës. Në këto raste gjithmonë bëhen marrëveshje paraprake.¹¹

Sidoqoftë, në Republikën e Maqedonisë nuk lejohet vërtetimi i atësisë së fëmijës i cili është zënë në mënyrë artificiale, qoftë nëse zënia është bërë nga qelizat e burrit të nënës apo të ndonjë burri tjetër.

Sa i përket pranimi të atësisë, ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, në nenin 51 thotë: “Atësia mund të pranohet para ofiqarit, qendrës për punë sociale dhe gjykatës. Organi tek i cili është dhënë ky pranim është i obliguar që pa shtyerje procesverbalin për pranimin e atësisë ta dërgojë deri tek ofiqari përgjegjës për regjistrimin e fëmijës në librin amzë të të lindurve. Njohja e atësisë mund të bëhet edhe me testament.”

Deklarata për pranimin e fëmijës që lind jashtë bashkësisë martesore, mund të jepet edhe nëpërmjet autorizuesit, si dhe mund të jepet para se të lind fëmija. Autorizimi duhet të jetë i vërtetuar dhe të përmbajë autorizim të përvokueshëm. Ndërsa deklarata e dhënë para se të lind fëmija, do të ketë efekt juridik vetëm nëse fëmija do të lind i gjallë.¹²

Pranimin e atësisë më hollësisht e sqaron neni 56 i ligjit për familje në RM, ku thuhet: “Pranimi i atësisë do të prodhojë efekt juridik dhe do të shënohet në librin amë të të lindurve nëse nëna e pranon atë, të cilën për këtë e njofton ofiqari. Deklaratën për pëlqimin e pranimi të atësisë nëna e jep në afat prej 30 ditësh pas pranimi të njoftimit. Në qoftëse nëna nuk është gjallë ose është zhdukur, me adresë të panjohur ose me zotësi të kufizuar të veprimi ose pa zotësi veprimi, deklaratën e jep kujdestari i fëmijës me aprovimin e qendrës për punë sociale.”

Gjithashtu, për pranimin e atësisë ka raste kur meret edhe pëlqimi i fëmijës. Neni 57 i ligjit për familje në RM, në lidhje me pëlqimin e pranimi të atësisë thotë: “Në qoftë se fëmija është më i vjetër se 16 vjeç, për pranimin e atësisë duhet edhe pëlqimi i tij. Deklarata për pëlqim jepet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të njoftimit. Në qoftë se fëmija është më i vogël se 16 vjeç, është nën kujdestari, sepse nëna është e vdekur, ose me vendbanim ose me vendqëndrim të panjohur, ose i vshtë marrë zotësia e veprimi, deklaratën e pëlqimit për pranimin e atësisë e jep kujdestari i fëmijës me aprovimin e qendrës për punë sociale.”

Në rastet kur nëna e fëmijës ose kujdestari i fëmijës nga të cilët duhet pëlqimi nuk pajtohen me pranimin e atësisë ose nuk deklarohen për atë në afat prej 30 ditësh pas pranimi

¹¹ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 202

¹² Ligji për familje i Repiblikës së Maqedonisë, neni 52 dhe 53

të njoftimit, personi që e ka pranuar fëmijën si të vetin, ka të drejtë të paraqesë padi për vërtetimin e atësisë.¹³

Deklarata për pranimin e atësisë si dhe deklarata e nënës dhe fëmijës për pëlqimin e pranimit të atësisë nuk mund të revokohet. Mirëpo, ekziston mundësia e anulimit të deklaratës nga personi i cili deklaratën e ka dhënë nën ndikimin e forces, mashtrimit apo lajthimit. Padia për anulimin e deklaratës mund të paraqitet në afat prej një viti nga dita kur lajthimi apo mashtrimi janë zbuluar.¹⁴

6.2. Kontestimi i atësisë dhe amësisë

Bashkëshorti mund ta kontestojë atësinë e fëmijës që e ka lindur bashkëshortja e tij gjatë kohëzgjatjes së martesës ose para kalimit të 300 ditëve nga zgjidhja e martesës në qoftëse konsideron që ai nuk është baba i fëmijës. Padia mund të parashtrohet në afat prej 3 muajve nga dita kur ka qenë në dijeni për lindjen e fëmijës. Nëse pas skadimit të afatit për ngritje të padisë, zbulohen fakte dhe dëshmi të cilat vërtetojnë se bashkëshorti nuk është baba i fëmijës, me kërkesë të tij Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë me aktvendim mund të përcaktojë afat të ri për parashttrimin e padisë për kundërshtimin e atësisë. Padia nuk mund të parashtrohet pasi fëmija të ketë arritur moshën madhore.¹⁵

Gjithashtu padi për kontestimin e atësisë mund të parashtrojnë edhe nëna e fëmijës si edhe vetë fëmija.

Amësinë mund ta kontestojë nëna e cila në librin amë është e regjistruar si nëna e fëmijës, në afat prej 3 muajve nga marja në dijeni se nuk është nënë e fëmijës. Gjithashtu, amësinë mund ta kontestojë gruaja e cila e llogarit veten si nënë të fëmijës por e cila në librin amë nuk është e regjistruar si nënë e fëmijës dhe në të njëjtën kohë mund të kërkojë vërtetimin e amësisë së vetë. Edhe fëmija ka të drejtë të kontestojë amësinë deri në arritjen e moshës 21 vjeçare.¹⁶

Në nenin 71 të ligjit për familje të RM-së thuhet: “Kontestimi i atësisë nuk është i lejuar kur nëna, me pajtim me shkrim të bashkëshortit të saj, është frytëzuar me insemenim artificial.”

Ndërsa, neni 72 i po këtij ligji thotë: “Atësia nuk mund të kontestohet pas vdekjes së fëmijës.”

¹³ Neni 58, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

¹⁴ Neni 59, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

¹⁵ Neni 60 dhe 65, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

¹⁶ Neni 68, 69 dhe 70, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

Trashëgimtarët ligjor të babait, nënës dhe fëmijës, nuk kanë të drejtë të parashtrojnë padi për kontestimin e atësisë apo amësisë. Ato kanë të drejtë që vetëm ta vazhdojnë procedurën e inicuar prej tyre.¹⁷

7. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve

Në ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë, neni 46 thotë: “Prindërit kanë të drejtë dhe obligim t’i mbajnë fëmijët e tyre të mitur, të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre, t’i përgadisnin ata për jetë e punë të pavarur, të kujdesen për edukimin e tyre, shkollimin dhe aftësimin profesional të tyre”.

Konventa e OKB-së mbi të drejtat e fëmijëve e miratuar më 1989, në nenin 6 thotë: “Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar”, si dhe: “Duhet të merren të gjitha masat e mundëshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës”.

Prindërit janë personat e parë për të cilët linden të drejta dhe detyra që duhet ti zbatojnë ndaj fëmijëve të tyre, siç janë: a) vënia e emrit personal të fëmijës; b) rruajtja dhe mirërritja; c) edukimi dhe arsimimi; ç) mbajtja (ushqimi); d) përfaqësimi i fëmijës; dh) administrimi i pasurisë e) mbledhja e fryteve nga pasuria dhe përdorimi i tyre; si dhe ë) tjetërsimi dhe ngarkimi i pasurisë.

a) Vënia e emrit personal të fëmijës

Në ligjin për emrin personal të Republikës së Maqedonisë, në nenin 1 thuhet: “Emri personal është e drejtë personale e qytetarit. Qytetari përdor emrin të cilin e ka të shënuar në librin amë të të lindurve.”

Këtë të drejtë e parasheh edhe Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve. Për këtë më saktësisht shkruan neni 7: “Fëmija regjistrohet menjëherë posa të lind dhe qysh atëherë e ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.”

E drejta për një emër personal i takon çdo fëmije të lindur, i cili përbëhet nga emri personal dhe mbiemri (emri familjar). Prindërit bashkërisht i’a caktojnë emrin fëmijës së tyre me marrëveshje. Në raste të parashikuara me ligj, emrin mund ta caktojë vetëm njëri prind (në rastet e heqjes, kufizimit apo pezullimit të së drejtës prindore, ose kur nuk është gjallë prindi, ose kur prindi është i panjohur). Në rastet kur egvizston mosmarrëveshje mes prindërve lidhur

¹⁷ Neni 73, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

me emrin vendos organi i kujdestarisë pasi të ketë dëgjuar mendimin e të dy prindërve. Fëmijës pa prind, i'a cakton emrin organi i kujdestarisë.¹⁸

Prindërit mund t'ia vëndojnë fëmijës emrin lirisht, pasi nuk ka listë me emra të përcaktuar me ligj. Mirëpo, ato nuk kanë të drejtë fëmijës t'ia vëndojnë emër fyes apo emër që është në kundërshtim me zakonet apo botëkuptimet e mjedisit ku ato jetojnë. Në të kundërtën, ofiqari ka të drejtë që të refuzojë regjistrimin e emrit të tillë dhe në qoftëse vetë prindërit nuk caktojnë emër tjetër, emrin do ta caktojë organi i kujdestarisë.¹⁹

Edhe sipas të drejtës Islame, fëmija duhet të ketë emër të mirë. Ai nuk duhet të ketë emër me të cilin do të turpërohet apo do të lëndohet, sidomos kur të rritet.²⁰

Përpos emrit, prindërit kanë të drejtë dhe detyrë siç e theksuam edhe më lartë, që fëmijës t'ia caktojnë edhe mbiemrin. Si mbiemër fëmija mund të merr vetëm mbiemrin e njërit ose mbiemrin e të dy prindërve. Ndërsa, në rastet kur prindërit kanë më tepër fëmijë të përbashkët, nuk mund që t'u caktojnë mbiemra të ndryshëm.²¹

Rruajtja dhe mirërritja

Rruajtja dhe mirërritja e fëmijëve është përgjegjësi e prindërve e cila njëkohësisht është e drejtë dhe detyrë e paraparë edhe me ligj. Prindërit kanë për detyrë që t'ia ruajnë fëmijët e tyre nga çfarëdo rreziku që mund t'iu kanoset si dhe të ruajnë shëndetin dhe mjekimin e tyre. Ata kanë për detyrë që fëmijëve të tyre tu sigurojnë kushte për zhvillim normal fizik dhe psikik.²²

Jo vetëm kaq, por për ruajtjen e fëmijëve kujdesen shumë organe tjera shtetërore. Për fëmijët, prindërit e të cilëve punojnë, janë hapur edhe qendra për ruajtjen e fëmijëve, të ashtuquajtura çerrdhe të fëmijëve. Gjithashtu, në dobi të fëmijëve të posalindur, nënat të cilat janë në marrëdhënie pune, marrin disa muaj pushim me qëllim që të risin fëmijën.

Për këtë flet më mire Ligji për marrëdhënie të punës në Republikën e Maqedonisë, në nenin 165 alineja 1, ku thuhet: “Punëtorja gjatë kohës së shtatëzansisë, lindjes dhe amësisë ka të drejtë në pushim nga puna me pagesë në kohëzgjatje prej nëntë muajsh pandërprerë, e nëse lind më shumë fëmijë përnjëherë (binjakë, trinjakë dhe më shumë) një vit”.

Gjithashtu, neni 171 i Ligjit për Marrëdhënie të punës në Republikën e Maqedonisë, thotë: “Punëtorja që i jep gji fëmijës dhe pas skadimit të mungesës për shkak të shtatëzansisë,

¹⁸ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 123

¹⁹ Po aty, faqe 123

²⁰ Al-Marzouqi Ibrahim Abdulla, Human rights in Islamic Law, 2000 Abu Dhabi, faqe 251

²¹ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 123

²² Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 226

lindjes dhe amësisë dhe e cila fillon të punojë me orar të plotë të punës, ka të drejtë në pauzë të paguar gjatë kohës së punës, në kohëzgjatje prej një orë e gjysmë në ditë, në të cilën kohë llogaritet edhe pauza e ditës. Atë të drejtë e ka punëtorja deri në mbushjen e një viti të moshës së fëmijës”.

Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve, në nenin 18 thotë: “Shtetet pale u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët. Shtetet palë nënshkruese marrin të gjitha masat e nevojshme për t’u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët, për të cilat janë ngritur.”

b) Edukimi dhe arsimimi

Pasi është shumë me rëndësi për zhvillimin e fëmijëve edukimi dhe shkollimi i tyre, prindërit kanë për detyrë që fëmijëve t’ua mundësojnë këtë. Prindërit duhet të kenë kujdes të veçantë për aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve gjatë edukimit dhe shkollimit të tyre, pasi që është shumë me rëndësi se si gjatë kësaj periudhe fëmiju do të formësohet si personalitet sepse në të ardhmen do të ndikoj si në rrethin e tij të ngushtë ashtu edhe në shoqërinë në përgjithësi.²³

Kuptohet që jo të gjithë prindërit kanë kushte të mira dhe mundësi që tu ofrojnë fëmijëve të tyre një shkollim, andaj për këtë mund të marrin ndihmë edhe nga institucionet të cilat merren me edukimin dhe shkollimin e fëmijëve.²⁴

Në Republikën e Maqedonisë, është paraparë veprimtaria e përkujdesjes dhe edukimit të fëmijëve prej moshës parashkollore deri në moshën 6 vjeçare. Deri sa fëmija të mbush moshën për përfshirje në arsimin fillor, sigurohet në çerdhe të fëmijëve.²⁵

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 47 flet për arsimimin: “Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabartë për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”

Kjo e drejtë e fëmijës është paraparë edhe nga shtetet palë të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve, ku neni 28 shkruan: “Shtetet pale njohin të drejtën e fëmijës për arsimin

²³ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 125

²⁴ Po aty, faqe 125

²⁵ Udhëzues për qytetarët, Për strukturën, ingjercat dhe shërbimet e Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, 2009 Shkup, faqe 170

dhe me qëllim që kjo e drejtë të arrihet hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ato:

- Bëjnë arsimimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
- Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm, duke përfshirë arsimin e përgjithshëm dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatëshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;
- U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatëshme;
- Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional;
- Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes të braktisjes së shkollës.”

ç) Mbatja (ushqimi)

Mbatja e fëmijës nënkupton detyrën e prindërve që fëmijës t’i sigurojnë të mira materiale për plotësimin e nevojave jetësore, si ushqimin në kuptim të ngushtë të fjalës, ashtu edhe edukimin, shkollimin, veshëmbathjen, mjekimin, e kështu me rradhë. Kur prindërit jetojnë një martesë të shëndoshë, edhe detyrën për ushqimin e fëmijëve e kryejnë së bashku. Mirëpo, ka raste ku për shkak të shkurorëzimit të martesës, anulimit të martesës, apo ndërprerjes faktike të jetës së përbashkët, ato nuk mundën që të bëjnë marrëveshje se si do ta kryejnë këtë detyrë. Prandaj, në këto raste, detyrimin për ushqim e cakton gjykata duke marrë parasysh nevojën e fëmijut, si dhe mundësitë e prindërve, ashtu cakton edhe lartësinë e shpenzimeve.²⁶

Kur është në pyetje mbajtja e fëmijëve, edhe organet tjera përkatëse u ndihmojnë prindërve që ta kryejnë këtë detyrë. Prandaj ekzistojnë edhe ndihmat sociale për prindërit që nuk kanë të mira materiale të mjaftueshme për kryerjen e kësaj detyre.

Në Republikën e Maqedonisë, shteti mundëson shtojcat fëmijërore, të cilat janë sigurim në të holla për mbulimin e një pjese të shpenzimeve në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Shtojca fëmijërore realizohet varësisht nga mosha e fëmijës si dhe varësisht nga gjendja materiale e familjes. Të drejtën e shtojcës fëmijërore e ka njëri prind deri në moshën 18 vjeçare të fëmijës.²⁷

²⁶ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 125

²⁷ Udhëzues për qytetarët, Vepër e cituar, faqe 163

Gjithashtu, në Republikën e Maqedonisë ekziston mundësia e ndihmës për pajisje të foshnjës së posalindur, e cila është ndihmë e njëherëshme për familjen që i jepet për fëmijën e pare të posalindur si kompensim në të holla.²⁸

Përgjegjësia e prindërve që të ushqejnë fëmijët pushon: me vdekjen e fëmijës apo me shpalljen e fëmijës për të vdekur; me vdekjen e prindit apo me shpalljen e prindit për të vdekur; me arritjen e moshës madhore të fëmijës ose kur është duke e vazhduar shkollimin deri në moshën 26 vjeçare; me emancipimin e fëmijës; si dhe me shuarjen e kushteve ligjore për dhënien e ushqimit.²⁹

c) Përfaqësimi i fëmijës

Neni 48 i ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë thotë: “Prindërit kanë të drejtë dhe obligim që t’i përfaqësojnë fëmijët e tyre të mitur. Fëmija ka të drejtë të përfaqësohet nga prindërit e tij ose tutorët (kujdestarët).”

Me përfaqësim të fëmijës nënkuptojmë kryerjen e veprimeve juridike nga ana e prindërve në emër dhe për llogari të fëmijëve, për të cilat nevojitet zotësia e veprimit. Pra, prindërit kanë të drejtë dhe detyrë t’i përfaqësojnë fëmijët e tyre të mitur, ato janë përfaqësues ligjor të tyre. Gjithmonë supozohet se me ndërmarrjen e veprimeve juridike nga ana e njërit prind, është dhënë pëlqimi i prindit tjetër. Në të kundërtën, nëse prindi tjetër nuk pajtohet, mund të kundërshtojë. Në qoftë se nuk do të ketë marrëveshje mes prindërve, atëherë ka të drejtë të ndërhyjë organi i kujdestarisë.³⁰

Prindërit i përfaqësojnë fëmijët e tyre në të gjitha veprimet juridike, përpara organeve shtetërore, përpos në disa raste kur për këtë duhet të marin leje nga organi i kujdestarisë. P.sh. prindërit duhet të marrin leje nga organi i kujdestarisë për të tjetërsuar dhe ngarkuar pasurinë e paluajtëshme të fëmijës. Në disa veprime prindërit nuk mundin t’i përfaqësojnë fëmijët e tyre, si p.sh. në lidhjen e martesës, kundërshtimin e amësisë apo atësisë, njohjen e amësisë apo atësisë, etj. Gjithashtu nuk mund t’i përfaqësojnë ato në kontestet ku vetë prindi paraqitet si palë, si dhe në rastet kur ka konflikt interesash mes prindit dhe fëmijës. Rast tjetër është rasti kur prindi nuk mund të jetë përfaqësues i fëmijës në veprimet që kanë të bëjnë me disponimin e të ardhurave që fëmija i realizon pas arritjes së moshës 15 vjeçare, me punë.³¹

²⁸ Po aty, faqe 168

²⁹ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 229

³⁰ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 127

³¹ Po aty, faqe 127

Prindi në tërësi e përfaqëson fëmijën deri në moshën 14 vjeçare. Pas mbushjes së moshës 14 vjeçare, prindi nuk e përfaqëson fëmijën në tërësi, pasi në këtë moshë fëmija fiton zotësi të pjesërishtme të veprimit. Në rastet kur vazhdohet e drejta prindore, vazhdohet edhe e drejta dhe detyra e prindit që ta përfaqësojë fëmijën, deri sa të zgjasë e drejta prindore.³²

dh) Administrimi i pasurisë

Pasurinë e fëmijës deri sa ai të arrijë moshën madhore e administrojnë prindërit e tij. Fëmija mund të ketë pasuri personale të fituar në mënyra të ndryshme, si: me trashëgim, dhurim, apo me formë tjetër të paraparë me ligj. Gjatë administrimit të pasurisë së fëmijës, prindi duhet të merr masa dhe veprime të ndryshme me qëllim që t'a ruajë dhe t'a shtojë pasurinë e tij.³³

Të ardhurat e realizuara nga pasuria personale e fëmijës prindërit duhet që t'i shfrytëzojnë për ushqim, edukim dhe shkollim të fëmijës. Nëse prindërit nuk kanë mjete të nevojshme për sigurimin e ekzistencës, pasurinë e fëmijës mund që t'a shfrytëzojnë edhe për plotësimin e nevojave të përbashkëta ekzistenciale për familjen.³⁴

e) Mbledhja e fryteve nga pasuria dhe përdorimi i tyre

Pasuria e fëmijës mund të jepë fryte natyrore ose civile. Prindërit këto fryte duhet t'i përdorin për ushqim, edukim dhe shkollim të fëmijës në rradhë të parë, ndërsa në qoftë se prindërit nuk kanë mjete të mjaftueshme, pasurinë e fëmijës mund ta përdorin edhe për nevoja të domosdoshme të bashkësisë familjare. Në rastet kur fëmija punon vetë, ai do të vendos vetë për përdorimin dhe tjetërsimin e fryteve nga pasuria e tij.³⁵

ë) Tjetërsimi dhe ngarkimi i pasurisë

Tjetërsimi dhe ngarkimi i pasurisë domethënë shitja e pasurisë, vënia e hipotekës mbi pasurinë, depozitim, etj. Prindërit mund ta tjetërsojnë ose ta ngarkojnë pasurinë e fëmijës me

³² Po aty, faqe 127

³³ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 230

³⁴ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, 2005 Prishtinë, faqe 183

³⁵ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 129

leje nga organi i kujdestarisë, por vetëm në dobi dhe interes të fëmijës, për ushqim, edukim dhe shkollim të tij.³⁶

Pos të drejtave që i përmendëm më lartë, fëmijët gjithashtu kanë të drejtë që të jetojnë me prindërit e tyre. Fëmijët mund të jetojnë të ndarë nga prindërit vetëm atëherë kur është në pyetje interesi më i lartë i tyre, apo atëherë kur ky vendim do të jetë në interes të të dy palëve, pra të fëmijëve dhe të prindërve. Në rastet kur fëmija do të jetojë me njërin prind, ekziston mundësia që prindi tjetër, me të cilin nuk jeton fëmija, të vazhdojë të mbajë kontakte me fëmijën dhe në qoftëse për çfarëdo lloj shkak nuk kryhet kjo e drejtë e fëmijës, qendra për punë sociale ka të drejtë që të merr vendim lidhur me mënyrën se si do të mbahen kontaktet e fëmijës me prindin.³⁷

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 5, alineja 5 thotë: “Secili fëmijë gëzon të drejtë për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtëpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.”

³⁶ Po aty, faqe 129

³⁷ Spiroviq-Tërpenovska Liljana, vepër e cituar, faqe 147

KAPITULLI I DYTË

USHTRIMI I TË DREJTËS PRINDORE

Neni 76 i ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë sa i përket ushtrimit të së drejtës prindore thotë: “Të drejtën prindore prindërit e ushtrojnë bashkërisht dhe me marrëveshje. Në rast të mosmarrëveshjes së prindërve në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindore vendos Qendra për punë sociale”.

Pra, të drejtën prindore e ushtrojnë babai dhe nëna gjithëmonë në interes të fëmijëve. Që të dy prindërit të ushtrojnë të drejtën prindore nisemi nga ajo se të dy prindërit i kanë të drejtat e barabarta sa i përket ushtrimit të së drejtës prindore ndaj fëmijëve. Megjithatë, ekzistojnë raste kur të drejtën prindore e ushtron vetëm njëri prind.³⁸

Ka raste, kur për shkak të mungesës së prindërve apo të njërit prind nga vendi i jetesës, i cili për një kohë të caktuar dhe për arsye të caktuara dhe të lejueshme nuk mund ta merr edhe fëmijën me vete, fëmija i besohet në rruajtje dhe edukim një personi të tretë. Mirëpo këtë veprim fillimisht duhet ta miratojë qendra për punë sociale.³⁹

1. Mbikqyrja e ushtrimit të së drejtës prindore

Mbikqyrjen e ushtrimit të së drejtës prindore e bën qendra për punë sociale. Ajo është e obliguar që të merr masa të nevojshme për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijëve. Fillimisht qendra për punë sociale ka mundësi që prindërit t'i paralajmërojë për mangësitë e tyre gjatë ushtrimit të së drejtës prindore, si dhe ka mundësi që t'i udhëzojë që të vizitojnë institucionet përkatëse të cilat mund t'u japin ndihmën e nevojshme përkatësisht këshilla për ushtrimin e të drejtës prindore. Por, nëse është e nevojshme dhe gjithëmonë flasim sa i përket interesave të fëmijëve, qendra për punë sociale mund të sjell aktvendim për mbikqyrje të përherëshme mbi ushtrimin e të drejtës prindore.⁴⁰

³⁸ Haxhivasilev Mile, vepër e cituar, faqe 315

³⁹ Spiroviq-Tërpenovska Liljana, vepër e cituar, faqe 161

⁴⁰ Neni 83, 84, 85 dhe 86, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

2. Mënyrat e ushtrimit të së drejtës prindore

Ekzistojnë disa mënyra për ushtrimin e të drejtës prindore, si: a) Ushtrimi i së drejtës prindore nga ana e të dy prindërve; b) Ushtrimi i së drejtës prindore nga ana e njërit prind; c) Ushtrimi i së drejtës prindore në interes të fëmijës; si dhe ç) Ushtrimi i së drejtës prindore është i lidhur ngushtë me personalitetin.

a) Ushtrimi i së drejtës prindore nga ana e të dy prindërve

Neni 76 i ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë, sa i përket ushtrimit të së drejtës prindore, thotë: “Të drejtën prindore, prindërit e ushtrojnë bashkarisht dhe me marrëveshje. Në rast të mosmarrëveshjes së prindërve në lidhje me ushtrimin e së drejtës prindore, vendos Qendra për punë sociale.” Pra, kjo e drejtë është e rezervuar për të dy prindërit në menyrë të barabartë, përpos në rastet e parashikuara me ligj.

b) Ushtrimi i së drejtës prindore nga ana e njërit prind

Të drejtën prindore e ushtron vetëm njëri prind, në rast se: prindit tjetër i është pezulluar, i është kufizuar ose i është hequr e drejta prindore; në rast se prindi tjetër ka vdekur, është i panjohur ose është shpallur për të vdekur; në rastet kur pas shkurorëzimit ose anulimit të martesës ose në rastë kur prindërit jetojnë të ndarë, vetëm njërit prind i është besuar fëmija; si dhe në rastet kur njërit prind i është kundërshtuar amësia apo atësia.⁴¹

Në rastet kur prindërit nuk jetojnë bashkë, atëherë do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakteve me fëmijën. Nëse për këtë në afat prej dy muajve nuk pajtohen për mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale, do të sjell aktvendim Qendra për punë sociale. Qendra për punë sociale do të merr edhe mendimin e fëmijës në varësi nga mosha dhe shkalla e zhvillimit të fëmijës dhe e informon atë për pasojat e mundëshme të vendimit.⁴²

Konvetnta e OKB-së për të drejtat e fëmijëve, në nenin 18 thotë: “Shtetet palë përpiqen me të gjitha mundësitë për të siguruar njohjen e parimit sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në rradhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës.”

⁴¹ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 138

⁴² Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, neni 79

Qendra për punë sociale me kërkesë të prindit mundet që prej fillimi të rregullojë mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale në qoftë se këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Kjo marrëdhënie e fëmijës me prindin mund të kufizohet ose përkohësisht të ndalohet për shkak të ruajtjes së shëndetit dhe interesave të fëmijës.⁴³

Gjithashtu neni 79 i ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë, thotë: “Në rastet kur nuk realizohet e drejta e fëmijës së mitur që të mbajë kontakte direkte me prindërit dhe të afërmit e tjerë të prindit i cili ka vdekur, të cilit i është marrë e drejta prindore apo për arsye të tjera është penguar që të ushtrojë të drejtën prindore, Qendra për punë sociale sjell aktvendim për mënyrën e mbajtjes së kontakteve direkte.”

Në rastet e shkurorëzimit të martesës, gjykata do të vendos për ruajtjen, edukimin dhe rritjen e fëmijëve të përbashkët. Gjykata fillimisht do të merr mendimin e Qendrës për punë sociale dhe do të hulumtojë rrethanat e mundshme, do të vendos nëse fëmija do të qëndrojë për ruajtje dhe edukim tek njëri prind, apo në rastet kur ka më tepër fëmijë nëse disa do të qëndrojnë tek njëri prind e disa tek prindi tjetër, apo të gjithë do t’i besohen ndonjë personi të tretë apo ndonjë institucioni.⁴⁴

Përveç rasteve të shkurorëzimit të martesës, gjykata duhet të vendosë për atë se kujt do t’i besohen fëmijët edhe në këto raste: kur do të sjellë vendim se martesa mes prindërve të fëmijës nuk ekziston; si dhe kur merr vendim për vërtetimin e atësisë apo amësisë.⁴⁵

c) Ushtrimi i të drejtës prindore në interes të fëmijëve

Gjithmonë e drejta prindore duhet të ushtrohet në interes të fëmijëve. Kjo nuk do të thotë që intereset e prindërve duhet të anashkalohen, mirëpo ato nuk duhet të vihen mbi interesat e fëmijëve. Organi i kujdestarisë kujdeset për interesin e fëmijëve, andaj bën mbikqyrjen e ushtrimit të së drejtës prindore. Në raste të caktuara me ligj, organi i kujdestarisë ka për detyrë të marrë masa të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve.⁴⁶

⁴³ Neni 79, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

⁴⁴ Neni 79, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

⁴⁵ Spiroviq-Tërpenovska Liljana, vepër e cituar, faqe 162

⁴⁶ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 138

ç) Ushtrimi i së drejtës prindore është i lidhur ngushtë me personalitetin

Të drejtën prindore e ushtrojnë prindërit, personalisht. Ushtrimin e kësaj të drejte nuk mund t'ua besojnë personave të tretë. E dreja prindore është e drejtë subjektive, e lidhur ngushtë me personalitetin e prindërve dhe fëmijëve. Pra, kjo e drejtë nuk mund as të cedohet, as të trashëgohet, e as të bartet tek personat e tretë.⁴⁷

Përpos rasteve të përmendura më lartë, nëse prindërit ose prindi që e ushtron të drejtën prindore, për shkaqe të arsyeshme largohet nga vendi i jetesës për një kohë më të gjatë pa fëmijën, fëmija mund t'i besohet për ruajtje dhe edukim një personi të tretë, nëse këtë vendim e miraton edhe Qendra për punë Sociale.⁴⁸

3. Pezullimi i të drejtës prindore

Pezullimi i të drejtës prindore ekziston atëherë kur ekzistojnë shkaqet të cilat shfaqen si pengesë për ushtrimin e të drejtës prindore. Këto shkaqe janë: faktike dhe ligjore.

a) Shkaqet faktike të pezullimit të së drejtës prindore

Këto shkaqe janë rrethana të cilat e pengojnë drejtëpërdrejtë prindin që ta ushtrojë të drejtën prindore. Shkqe të tilla janë sëmundjet e ndryshme, vuajtjet e dënimeve, udhëtimet e ndryshme, etj.

b) Shkaqet ligjore të pezullimit të së drejtës prindore

Këto shkaqe janë heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, i njërit prind apo i të dy prindërve. Që prindi ta ushtrojë të drejtën prindore duhet të ketë zotësinë për të vepruar, në të kundërtën nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë. Kur prindi nuk ka zotësi për të vepruar, ai nuk është në gjendje që t'i ushtrojë edhe të drejtat e veta, prandaj edhe vetë ai duhet të vendoset nën kujdestari, për këtë arsye ai nuk mund ta ushtrojë të drejtën prindore.

Në qoftë se vetëm njëri prind nuk ka zotësi për të vepruar, të drejtën prindore e ushtron prindi tjetër. Ndërsa në rastet kur tek të dy prindërit pezullohet e drejta prindore, këtë të drejtë e ushtron personi i tretë, pra fëmija vendoset nën kujdestari të personit të tretë.

⁴⁷ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 139

⁴⁸ Neni 77, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë

Pezullimi i së drejtës prindore do të zgjas për aq sa zgjasin shkaqet e pezullimit. Në momentin që do të shuhen këto shkaqe, do të pushojë edhe pezullimi.⁴⁹

4. Kufizimi i së drejtës prindore

Ushtrimi i së drejtës prindore mund të kufizohet, në rastet kur prindi sillet në mënyrë të papërgjegjshme ndaj fëmijës, abuzon të drejtat prindore dhe rrezikon personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijës. Me sjelljen e tij prindi mund të rrezikojë zhvillimin psikik dhe fizik të fëmijës. Për këtë arsye, organi i kujdestarisë ushtron mbikqyrjen ndaj ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindore.⁵⁰

Në rastet kur organi i kujdestarisë gjatë mbikqyrjes së ushtrimit të së drejtës prindore vëren shkeljen e kësaj të drejte, mund të bëj: a) kufizimin e së drejtës prindore në pikëpamje të të drejtave dhe detyrave ndaj personalitetit të fëmijës; si dhe b) kufizimin e të drejtës prindore në pikëpamje të të drejtave dhe detyrave ndaj pasurisë së fëmijës.

a) Kufizimi i të drejtës prindore në pikëpamje të të drejtave dhe detyrave ndaj personalitetit të fëmijës

Sa i përket të drejtave dhe detyrave ndaj personalitetit të fëmijës, organi i kujdestarisë mund të merr këto masa: t'ia tërheq vërejtjen prindit; të caktojë mbikqyrje të vazhdueshme ndaj ushtrimit të së drejtës prindore; si dhe t'ia marrë fëmijën prindit.

Tërheqja e vërejtjes ndaj prindit bëhet në rastet kur organi i kujdestarisë heton mangësi në ushtrimin e të drejtës prindore. Kështu organi i kujdestarisë në bashkëpunim me këshillimore të familje, me institucionet shëndetësore, sociale, edukative si dhe me institucione tjera përkatëse, u ofron prindërve ndihmë profesionale për kryerje të drejtë të detyrave prindore.

Caktimi i mbikqyrjes së vazhdueshme ndaj ushtrimit të së drejtës prindore vjen në shprehje kur organi i kujdestarisë heton se masa e shqiptuar më herët (tërheqja e vërejtjes ndaj prindit) nuk ka pasur rezultate të duhura. Kjo masë mund të caktohet vetëm ndaj disa të drejtave dhe detyrave të caktuara ose në tërësi. Gjithashtu, vlen të theksohet se kjo masë mund të caktohet sa i përket ushtrimit të së drejtës prindore ndaj njërit fëmijë ose ndaj të gjithë fëmijëve. Qëllimi i kësaj mase është që organi i kujdestarisë të ushtrojë mbikqyrje të

⁴⁹ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 235

⁵⁰ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 192

vazhdueshme ndaj prindit dhe të ndikojë në mënyrë pozitive sa i përket interesave të fëmijëve, lidhur me edukimin, shkollimin, ruajtjen, mirëritjen, etj.

Marrja e fëmijës nga prindi bëhet atëherë kur organi i kujdestarisë heton që dy masat e shqipëtuara më parë, nuk kanë dhënë rezultatet e duhura dhe për këtë arsye i kanoset rrezik serioz interesit të fëmijës. Organi i kujdestarisë i'a merr fëmijën prindit dhe i'a beson për rruajtje dhe edukim një personi të tretë, ose ndonjë institucioni përkatës për përkujdesjen e fëmijëve. Qëllimi i kësaj mase është që të pengohet rreziku i përkujdesit të fëmijës, për shkak të rrethanave të krijuara në familje, qofshin ato objektive apo subjektive. Këto rrethana mund të jenë: sëmundja e rëndë e prindit, alkoolizmi kronik i prindit, narkomania e prindit, prostitucioni, bixhozi, etj.

Tërheqja e vërejtjes ndaj prindit si dhe mbikqyrja e vazhdueshme ndaj ushtrimit të së drejtës prindore janë masa më të buta në krahasim me heqjen e së drejtës prindore, ku kufizimi i kësaj të drejte bëhet në mënyrë të plotë.

Gjithashtu, duhet theksuar se kufizimi i së drejtës prindore është dënim më i butë ndaj prindit, krahasuar me heqjen e së drejtës prindore, ngase prindit i kufizohen vetëm disa të drejta dhe detyra ndaj fëmijës, por edhe më tej ka për detyrë ta mbajë fëmijën, ta përfaqësojë dhe të kujdeset për pasurinë dhe interesat tjera të fëmijës.

b) Kufizimi i të drejtës prindore në pikëpamje të të drejtave dhe detyrave ndaj pasurisë së fëmijës

Kufizimi i të drejtës prindore mund të vijë në shprehje edhe në lëminë e të drejtave dhe detyrave ndaj pasurisë së fëmijës. Me qëllim të mbrojtjes së interesave pasurore të fëmijës, organi i kujdestarisë mund të merr këto masa: të kërkojë nga prindërit dhënien e llogarisë për administrimin e pasurisë së fëmijës; të kërkojë lejimin e mjeteve të sigurimit mbi pasurinë e prindit; si dhe të kërkojë që prindi në pikëpamje të administrimit të pasurisë së fëmijës të barazohet me pozitën e kujdestarit.

Dhënia e llogarisë për administrimin e pasurisë së fëmijës nga ana e prindit jepet tek organi i kujdestarisë atëherë kur ekziston dyshimi i bazuar se prindi nuk e administron me mirëbesim dhe si shtëpiak i mirë pasurinë e fëmijës.

Lejimi i mjeteve të sigurimit mbi pasurinë e prindit ka për qëllim që të sigurojë kompensimin e dëmit që i është shkaktuar apo që mund t'i shkaktohet pasurisë së fëmijës nga ana e prindit. Në qoftë se organi i kujdestarisë në bazë të shikimit të llogarisë për administrimin e pasurisë së fëmijës konstaton se janë bërë lëshime dhe tejkalime, nga gjykata do të kërkojë që

në procedurë jashtëkontestimore të lejojë mjetet e sigurimit, si: konstituimin e hipotekës, pengut, dorëzani, etj.

Barazimi i pozitës së prindit me pozitën e kujdestarit në pikëpamje të administrimit të pasurisë së fëmijës bëhet atëherë kur organi i kujdestarisë konstaton se masat e theksuara më parë nuk kanë dhënë rezultatet e duhura. Në këtë rast organi i kujdestarisë kërkon nga gjykata që prindi të barazohet me pozitën e kujdestarit. Prindi do të jetë i detyruar që të jep llogari periodike dhe sa herë që këtë ta kërkojë organi i kujdestarisë, si dhe prindi pa lejen e organit të kujdestarisë nuk do të mund të ndërmer veprime që dalin jashtë veprimtarisë së rregullt të administrimit të pasurisë së fëmijës.⁵¹

5. Pushimi i së drejtës prindore

Pushimi i së drejtës prindore nuk është dënim ndaj prindit, por pushim i natyrshëm i ushtrimit të së drejtës prindore dhe njëkohësisht pushim i përhershëm, pra ushtrimi i të drejtës prindore pushon në mënyrë përfundimtare.⁵²

Sipas ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë, nenit 93: “E drejta prindore pushon me arritjen e moshës madhore të fëmijës, me lidhjen e martesës nga fëmiu para arritjes së moshës madhore (emancipimi) dhe me adoptim.”

Në teori të ndryshme juridike hasim në këtë ndarje të pushimit të së drejtës prindore: a) me vdekjen e prindit ose të fëmijës; b) me arritjen e moshës madhore të fëmijës; si dhe c) me emancipimin e fëmijës.

a) Pushimi i së drejtës prindore me vdekjen e prindit ose fëmijës

Pasi që ushtrimi i të drejtës prindore është i lidhur ngushtë me personalitetin e prindit dhe të fëmijës, e drejta prindore pushon me vdekjen e njërit prej tyre. Pra, qoftë vdekja e prindit apo e fëmijës, në mënyrë të natyrshme e shkakton pushimin e të drejtës prindore.

b) Pushimi i së drejtës prindore me arritjen e moshës madhore të fëmijës

Me arritjen e moshës madhore, konsiderohet që fëmija është bërë i zoti të kujdeset vetë për personalitetin e tij, të drejtat dhe interesat e tij. Me fjalë të tjera me arritjen e moshës

⁵¹ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 141

⁵² Po aty, faqe 146

madhore, fëmija e fiton zotësinë për të vepruar. Prandaj, me arritjen e kësaj moshe pushon edhe e drejta prindore.

c) Pushimi i së drejtës prindore me emancipimin e fëmijës

E drejta prindore pushon edhe me emancipimin e fëmijës, pasi edhe pse fëmija nuk e ka arritur moshën madhore, me emancipin ai e fiton zotësinë për të vepruar. Përderisa ndodh kjo, pushon edhe e drejta prindore. Emancipimi mund të jetë: emancipim i plotë; si dhe emancipim i pjesërishtëm.

Emancipimi i plotë i fëmijës bëhet atëherë kur ai, me leje të gjykatës, lidh martesë para se të arrijë moshën madhore, pra në moshën gjashtëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeçare. Në këtë rast fëmija e fiton zotësinë për të vepruar dhe nuk e humb atë edhe nëse martesa e tij anulohet ose shkurorëzohet para se ai të ketë mbushur moshën madhore. Pra me këtë lloj emancipimi, fëmija e fiton zotësinë e plotë për të vepruar.

Emancipimi i pjesërishtëm i fëmijës bëhet kur ai, pasi të ketë arritur moshën pesëmbëdhjetë vjeçare krijon marrëdhënie pune. Te ky lloj emancipimi fëmija fiton zotësinë e pjesërishtme për të vepruar, që domethënë se ai disponon në mënyrë të pavarur të ardhurat që i realizon nga puna.⁵³

6. Vazhdimi i të drejtës prindore

Fëmijët janë nën kujdesin prindor deri në arritjen e moshës madhore, mirëpo e drejta prindore mund të vazhdojë edhe pas arritjes së kësaj moshe, në qoftëse për këtë ekzistojnë shkaqet e parashikuara me ligj. E drejta prindore mund të vazhdojë për disa shkaqe, siç janë: sëmundjet psikike të diagnostifikuara, ngecja në zhvillimin psikik apo të metat fizike, apo shkaqe të tjera shëndetësore për të cilat fëmija nuk është i aftë që të kujdeset për personalitetin dhe interesat e tij. Pra, vazhdimi i të drejtës prindore bëhet atëherë kur një personi fizik i cili e ka arritur moshën madhore i hiqet zotësia për të vepruar ose nuk e fiton aspak edhe në momentin kur ai e arrin moshën madhore.⁵⁴

Edhe në ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë, në nenin 94 është folur për vazhdimin e të drejtës prindore, ku thuhet: “Gjykata me propozim të prindërve apo të Qendrës për punë sociale mundet që në procedurë jokontestimore të vendosë që prindërit të ushtrojnë të drejtën prindore nëse fëmija edhe pas arritjes së moshës madhore për shkak të pengesave

⁵³ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 146

⁵⁴ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 242

në zhvillimin psikik, nuk është i aftë të kujdeset për personalitetin, të drejtat dhe interesat e veta.”

a) Procedura për vazhdimin e të drejtës prindore

Vendimin për vazhdimin e të drejtës prindore e merr gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore, me kërkesë të prindërve apo të organit të kujdestarisë. Prindërit paraqesin kërkesë bashkë ose vetëm njëri prej tyre, atëherë kur vetëm njëri e ushtron të drejtën prindore.⁵⁵

Me rëndësi është që propozimi për vazhdimin e të drejtës prindore duhet të paraqitet para se fëmija të ketë arritur moshën madhore. Mirëpo, ekziston përjashtimi, kur gjykata mund të zhvillojë këtë procedurë dhe të merr vendim edhe pse propozimi nuk është paraqitur në kohë, në rastet kur kanë ekzistuar shkaqet për vazhdimin e të drejtës prindore përpara se fëmija të ketë arritur moshën madhore.⁵⁶

b) Efektet e vazhimit të së drejtës prindore

Me vazhdimin e së drejtës prindore, fëmija edhe pas arritjes së moshës madhore vazhdon të mbetet nën përkujdesin prindëror. Pra, prindërit vazhdojnë ta ushtrojnë të drejtën prindore. Mirëpo, ushtrimi i së drejtës prindore të vazhduar do të varet nga ajo se fëmija a barazohet me fëmijët e mitur të rinj (deri në moshën katërmëdhjetë vjeçare), ose me fëmijët e mitur të rritur (më të vjetër se moshën katërmëdhjetë vjeçare). Gjithësesi, në të dy rastet prindi duhet të kujdeset që të eliminohen shkaqet, të cilat kanë sjellë deri tek vazhdimi i së drejtës prindore.⁵⁷

c) Përfundimi i së drejtës prindore të vazhduar

E drejta prindore e vazhduar do të pushojë në momentin kur do të pushojnë shkaqet për të cilat ka ardhur deri tek vazhdimi i saj. Gjykata me kërkesë të personit, ndaj të cilit është vazhduar e drejta prindore, me kërkesë të prindërve të tij, apo të organit të kujdestarisë, do të vendos për përfundimin e së drejtës prindore të vazhduar. Ky vendim duhet të shënohet në librin amë të të lindurve, e nëse personi të cilit i është kthyer zotësia e veprimtari ka pasuri të

⁵⁵ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 199

⁵⁶ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 148

⁵⁷ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 243

paluajtëshme, vendimi duhet të shënohet edhe në regjistrat për regjistrimin e pasurive të paluajtëshme.⁵⁸

⁵⁸ Po aty, faqe 243

7. Heqja e të drejtës prindore

Heqja e të drejtës prindore paraqet një ndër masat më rigoroze respektivisht sanksion ndaj prindërve të cilët jo vetëm që nuk i kryejnë në mënyrë të drejtë dhe me vetëdije obligimet prindore ndaj fëmijëve, por edhe në mënyrë të rëndë neglizhojnë kryerjen e ushtrimit të së drejtës prindore si dhe e keqpërdorin të drejtën prindore.⁵⁹

Heqja e të drejtës prindore është situatë ekstreme e cila tregon se prindi nuk ka përgjegjshmëri morale që të vazhdojë të quhet prind i fëmijës dhe të ushtojë të drejtën prindore. Pra, heqja e të drejtës prindore është masë mbrojtëse ndaj të drejtave të fëmijës, të interesave të tij.⁶⁰

Sa i përket heqjes së të drejtës prindore, Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve në nenin 9 thotë: “Shtetet palë sigurojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e nevojshme për interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në një rast të veçantë, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.”

Pas marrjes së mendimit nga qendra për punë sociale, prindit i hiqet e drejta prindore në bazë të vendimit gjyqësor, në procedurë jashtëkontestimore, vetëm për shkaqe të parapara me dispozita ligjore, duke marrë për bazë mbrojtjen e interesave të fëmijëve. Heqja e të drejtës prindore mund të ketë efekt ndaj të gjithë fëmijëve, por mund të ndodh që të ketë efekt vetëm ndaj njërit fëmijë, psh. në rastet kur prindi sillet keq vetëm ndaj njërit fëmijë për shkak të antipatisë që ka ndaj tij, ndërsa ndaj të tjerëve ka sjellje të mira dhe korrekte.⁶¹

Si shkelje e rëndë konsiderohen sjelljet e prindit të cilat e rezikojnë jetën dhe shëndetin e fëmijës, si psh. kur fëmijës së sëmurë nuk i ofrohet ndihma mjeksore, nuk i sigurohet strehimi, veshëmbathja, ushqimi, edukimi, etj. Fëmijët gëzojnë mbrojtje në aspektin e të drejtës për të jetuar, mirërritje, edukim dhe arsimim, mbrojtje nga shfrytëzimet ekonomike, mbrojtje nga eksploatimi i tyre, nga trafikimit, nga eksploatimi seksual, nga keqtrajtimet dhe dhunimet, mbrojtje nga përdorimi i drogave dhe mjeteve tjera narkotike, etj. Përkujdesi i fëmijëve në rradhë të parë është përgjegjësi e prindërve, prandaj keqpërdorimi dhe shkelja e këtyre përgjegjësisë nga ana e prindërve paraqet shkak për heqjen e të drejtës prindore.⁶²

⁵⁹ Haxhivasilev Mile, vepër e cituar, faqe 317

⁶⁰ Mandro-Bilalli Arta, Vepër e cituar, faqe 429

⁶¹ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 196

⁶² Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 240

Heqja e së drejtës prindore vendoset nga gjykata, nëse vërtetohet se veprimet ose mosveprimet e prindit janë me faj, por jo ndaj prindit i cili nuk ka zotësi për të vepruar, ose ndaj prindit që për shkaqe të të metave fizike nuk mund të kujdeset për fëmijën e tij. Pra, për shkaqet që prindi nuk është fajtor nuk mund t'i hiqet e drejta prindore. Mirëpo, heqja e të drejtës prindore nuk nënkupton edhe heqjen e së drejtës për mbajtjen e kontakteve personale mes prindit dhe fëmijës, përveç se në rastet kur edhe këto kontakte janë në dëm për interesat e fëmijës. Pra, heqja e të drejtës prindore, nuk e shkarkon prindin nga detyrimi i ushqimit ndaj fëmijës.⁶³

Prindit që i hiqet e drejta prindore, do të thotë i hiqet e drejta që ta rruajë fëmijën e tij, ta mbajë, ta edukojë, ta shkollojë, ta përfqësojë apo të vendos për pasurinë e tij. Megjithatë, prindi ka për detyrë të vazhdojë ushqimin ndaj fëmijës.⁶⁴

Në Gjykatën themelore të Tetovës, që nga viti 2014 deri në vitin 2016, numri i përgjithshëm i rasteve të cilat janë zhvilluar për heqjen e të drejtës prindore është 7. Nga këto raste, vetëm 2 prindërve u është hequr e drejta prindore, në njërin rast padia hudhet poshtë si e pavlefshme, në 3 raste është tërhequr padia, ndërsa njëri rast ende është në procedurë gjyqësore. Për këto të dhëna praktike gjyqësore vijon tabela e mëposhtme.

VITI	Raste të zgjedhura të heqjes së të drejtës prindore	Padi e tërhequr	Padi e pavlefshme	Raste të cilat vazhdojnë të zhvillohen në procedurë gjyqësore
2014	/	1	/	/
2015	2	2	/	/
2016	/	/	1	1

Tabela nr. 1: Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Tetovë për procedurat e zhvilluara për heqjen e të drejtës prindore.

⁶³ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 197

⁶⁴ Draskic Marija, Porodico pravo i prava deteta, 2007 Beograd, faqe 308

7.1 Shkaqet e heqjes së të drejtës prindore

Nga gjithë ajo që u përmend edhe më lartë, vërejmë që shkaqet për heqjen e të drejtës prindore i ndajmë në: a) keqpërdorimi i të drejtës prindore; si dhe b) shkelja e rëndë e të drejtës prindore.

a) *Keqpërdorimi i të drejtës prindore* ekziston atëherë kur prindi e keqtrajton rëndë fizikisht ose psikikisht fëmijën, e nxit ose e shtrëngon të kryejë vepra penale, si psh. vjedhje, plaçkitje, mashtrime, ose e nxit të merret me prostitucion, të gjitha këto që vetë prindi të nxjerrë fitime materiale për vete.

b) *Shkelja e rëndë e së drejtës prindore* ka të bëjë me sjelljet e prindit, kur ai e rrezikon jetën dhe shëndetin e fëmijës, si psh. nuk kujdeset për fëmijën e sëmurë, nuk i siguron strehim, ushqim, etj.⁶⁵

Sipas ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë, neni 90: “Prindit i cili e keqpërdor ushtrimin e të drejtës prindore ose e anashkalon rëndë ushtrimin e obligimeve prindore pas marrjes së mendimit nga Qendra për punë sociale i merret ushtrimi i së drejtës prindore me aktvendim të gjykatës në procedurë jokontestimore. Si keqpërdorim ose anashkalim të rëndë të obligimeve prindore do të llogartitet nëse prindi:

- a) Ushtron dhunë fizike ose emocionale ndaj fëmijës;
- b) Seksualisht e keqpërdor (shfrytëzon) fëmijën;
- c) E detyron fëmijën në punë e cila nuk i përgjigjet moshës së tij;
- d) I lejon përdorimin e alkoolit, drogës ose substancave tjera psikotropike;
- e) E drejton fëmijën në sjellje shoqërore të papranueshme;
- f) E braktis fëmijën dhe më gjatë se tre muaj nuk kujdeset për fëmijën;
- g) Në çfarëdo qoftë mënyre tjetër dhunshëm i shkel të drejtat e fëmijës.”

a) *Dhuna fizike ose emocionale ndaj fëmijës*

Nuk mund të arsyetohet sjellja e prindërve të cilët ushtrojnë dhunë fizike apo emocionale ndaj fëmijëve të tyre. Ushtrimi i dhunës ndaj fëmijëve do të thotë shkelje e të

⁶⁵ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 143

drejtave të tyre për të jetuar. Kjo sjellje paraqet arsye që prindërve t'u hiqet e drejta prindore, pa marrë parasysh në qoftëse dhuna u ka lënë fëmijëve pasoja të cilat vërehen ose jo.⁶⁶

Sa i përket dhunës ndaj fëmijëve do ta paraqes një tabelë me të dhëna statistikore nga Qendra për punë sociale, në vitin 2005, duke përfshirë qytetet e ndryshme të Republikës së Maqedonisë.

QYTETI		Nr.	%
1	Manastir	30	13.76
2	Vallandovë	2	0.92
3	Vinicë	4	1.83
4	Gjevgjeli	6	2.75
5	Gostivar	3	1.38
6	Dibër	1	0.46
7	Dellçevë	4	1.83
8	Kavadarc	6	2.75
9	Kërçovë	3	1.38
10	Koçan	39	17.89
11	Kriva Pallanka	1	0.46
12	Krushevë	2	0.92
13	Kumanovë	4	1.83
14	Negotinë	6	2.75
15	Ohër	5	2.29
16	Prilep	12	5.50
17	Radovisht	1	0.46
18	Shën Nikollë	4	1.83
19	Strugë	1	0.46
20	Strumic	6	2.75
21	Tetovë	3	1.38
22	Veles	1	0.46
23	Shkup	74	33.95
Gjithësej		218	100%

Tabela nr.2 ⁶⁷

⁶⁶ Alincic Mira, Hrabar Dubravka, Jakovac-Lozic Dijana dhe Korac Aleksandra, Obitjelsko pravo, 2006 Zagreb, faqe 296

⁶⁷ Јавна установа Завод за социјални дејности, Истражувања и анализи, книга 2, 2007 Скопје, faqe 299

Në vazhdim do të paraqes një shembull të paraqitjes së dhunës në familje në Qendrën për punë sociale.

Deri te

*Qendra për punë sociale*_____

*Në bazë të nenit 94, alineja 1, në Ligjin për familje (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 80/92, 9/96 dhe 38/04), deri tek Qendra për punë sociale*_____, *parashtroj*

ANKESË

PËR KRYERJE TË DHUNËS NË FAMILJE

*Personi*_____ *prej*_____,
*rruga*_____ *nr.* _____, *ka ushtruar dhunë në familje*

(përshkruhet dhuna familjare)

*kundër personit*_____ *viktimë e dhunës familjare, nga* _____,
rruga _____ *nr.* _____, *i cili shtë* _____ *e kryerësit të dhunës familjare.*

Dhuna është ushtruar në vitin _____, *respektivisht që nga viti* _____ *deri në vitin* _____.

I propozoj Qendrës për punë sociale të ndërrmer masa dhe veprime për zgjidhjen e rastit, në kuadër të të drejtave të saj.

TË DHËNA PËR PARASHTRUESIN E KËRKESËS

Emri dhe mbiemri/ emri i personit juridik:

_____, *nga* _____ *rruga* _____ *nr.* _____

*LN nr.*_____, *Tel. nr.*_____.

*Në*_____

Parashtrues

*Në vitin*_____.

68

⁶⁸ Јавна установа Завод за социјални дејности, Истражувања и анализи, книга 2, 2007 Скопје, faqe 147

b) Keqpërdorimi (shfrytëzimi) i fëmijës

Për këtë veprim janë paraparë masa sanksionuese. Qendra për punë sociale sapo të informohet për keqpërdorimin e fëmijut nga ana e prindërve, është e detyruar ta paraqesë këtë vepër penale dhe njëkohësisht të paraqes në gjykatë faktet për t'iu hequr prindit e drejta prindore.⁶⁹

Në praktikë kemi raste të shumta ku fëmijët keqpërdoren nga prindërit e tyre në mënyra të ndryshme. Shpesh na ndodh të shohim nëpër rrugë fëmijë lypsarë. Qendra për punë sociale në këto raste fillimisht u jep vërejtje prindërve që të mos i keqpërdorin fëmijët e tyre si dhe sjell vendim për kontroll të mënyrës së kryerjes së të drejtës prindore dhe në qoftëse prindi vazhdon të keqpërdor fëmijën, vazhdon të keqpërdor ushtrimin e të drejtës prindore, atëherë do t'i merret fëmija dhe do të hapet procedura për heqjen e të drejtës prindore.

Nga të dhënat statistikore të vitit 2013, në qytetin e Shkupit në rrugë janë gjetur 27 fëmijë, ndërsa në qytetet tjera të Republikës së Maqedonisë janë gjetur 89 fëmijë. Nga 27 fëmijët në Shkup, 12 janë gjetur të vetëm ndërsa 15 në shoqëri të prindit apo ndonjë personi tjetër më të moshuar. Nga këto, 5 prindërve u është hequr e drejta prindore, ndërsa për 10 fëmijë të tjerë është shqiptuar mbikqyrje e të ushtrimit të së drejtës prindore, si dhe 7 fëmijë janë vendosur në përkujdesje familjare dhe një fëmijë në shtëpinë për dhënie gji në Manastir. Fëmijët e gjetur në qytetet tjera të Republikës së Maqedonisë, e drejta prindore u është hequr 3 prindërve për 6 fëmijë, masë e mbikqyrjes është vendosur për 35 prindër, 4 fëmijë janë vendosur në familje përkujdesëse, si dhe 5 fëmijë janë vendosur nëpër institucione tjera.⁷⁰

c) Detyrimi i fëmijës në punë e cila nuk i përgjigjet moshës së tij

Fëmijët kanë të drejtë të vendosin nëse duan të shkollohen ose të punojnë. Detyrimi i fëmijëve që të punojnë nga ana e prindërve të tyre, u shkel të drejtën për tu mbrojtur, të drejtën për mbrojtjen nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e punëve të rrezikshme ose të dëmshme, gjithashtu e drejta që të luajnë, të pushojnë apo të zbavitën. Ligji parasheh mundësinë që fëmijët t'u ndihmojnë prindërve të tyre, mirëpo kur kjo ndihmë është e tepruar, pra kur prindi keqpërdor këtë të drejtë, atij i hiqet e drejta prindore.⁷¹

Do të përdor si shembull një rast nga praktika e Gjykatës themelore të Shkupit. Qendra për punë sociale në qytetin e Shkupit ka parashtruar propozim për heqjen e të drejtës prindore

⁶⁹ Po aty, faqe 297

⁷⁰ <http://www.idividi.com.mk/shqip/magedoni/908393/index.html>

⁷¹ Јавна установа Завод за социјални дејности, Истражувања и анализи, книга 2, 2007 Скопје, faqe 297

në Gjykatën themelore të Shkupit në vitin 2009, ndaj prindërve K.B. dhe D.Z. të cilët kanë lindur një fëmijë ë bashkësi jashtëmartesore. Prindërit kanë qenë nën mbikqyrjen e Qendrës për punë sociale, për arsye se e kanë braktisur dhe kanë ushtruar dhunë fizike ndaj fëmijës së tyre të mitur M.Z. dhe jo vetëm kaq, nga shkolla fillore ku i ka ndjekur mësimet i mituri M.Z. Qendra për puna sociale ka qenë e informuar se ai nuk i ndjek mësimet rregullisht, mungon në shkollë dhe ka qenë i angazhuar nga babai i tij që të punojë, më saktësisht të mbledh hekur për të shitur dhe të hollat e fituara babai i tij i ka shfryëzuar për alkool. Për këtë arsye, prindërve K.B. dhe D.Z. u është hequr e drejta prindore.⁷²

d) Lejimi i përdorimit të alkoolit, drogës ose substancave tjera psikotropike

Prindërit mund të kërkojnë ndihmë nga institucionet përkatëse nëse fëmijët e tyre janë shfrytëzues të alkoolit, drogës apo substancave tjera dhe këto institucione u japin ndihmën e tyre. Mirëpo, nëse prindërit me vetëdije lejojnë që fëmijët e tyre t'i përdorin këto dhe nuk marrin masa për parandalimin e tyre, atëherë ato e rrezikojnë shëndetin dhe jetën e fëmijëve dhe në këtë rast mund t'u hiqet e drejta prindore.⁷³

e) Drejtimi i fëmijës në sjellje shoqërore të papranueshme

Prindi i cili është i pakujdesshëm në lidhje me sjelljet e papranueshme të fëmijës, nëse ai e udhëzon fëmijën që të kryej vepra kriminele, prostitucion e kështu me rradhë, atëherë ai mund të privohet nga e drejta prindore, respektivisht mund t'i hiqet e drejta prindore.

f) Braktisja e fëmijës

Prindi i cili e braktis fëmijën, më këtë ai shfaq mosinteresimin e tij ndaj fëmijës. Ky veprim i prindit tregon që ai nuk ka për qëllim që të kujdeset për fëmijën, për shëndetin dhe jetën e tij. Prandaj kjo është arsye që prindit t'i hiqet e drejta prindore.⁷⁴

Në Qendrën për punë sociale, në vitin 2015 janë evidentuar gjithësej 1317 fëmijë pa kujdes prindëror dhe ky numër ka paraqitur rritje të numrit të fëmijëve pa kujdesin prindëror që nga viti 2014.⁷⁵

⁷² Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Shkup, viti 2009.

⁷³ Alincic Mira, Hrabar Dubravka, Vepër e cituar, faqe 298

⁷⁴ Po aty, faqe 298

⁷⁵ <http://zsd.gov.mk>

Për braktisjen e fëmijës do të paraqes një rast nga praktika e Gjykatës themelore të Shkupit. Qendra për punë sociale në qytetin e Shkupit ka parashtruar propozim për heqjen e të drejtës prindore në Gjykatën themelore të Shkupit në vitin 2009, ndaj prindërve Z.H. dhe E.E. Vajza e tyre L.E. ka qenë e vendosur nën kujdestari, pra ka qenë nën kujdesin e gjyshit të saj. Ajo ka lindur në bashkësi jashtëmartesore dhe prindërit e saj kanë qenë vazhdimisht në zënka dhe mosmarrëveshje. Për këtë arsye nëna e saj largohet nga shtëpia dhe bashkëjeton me burrë tjetër me të cilin ka edhe fëmijë tjetër. Për shkak se burri i saj nuk e pranon vajzën e saj, ajo e braktisi atë. Gjithashtu, babai i L.E. është narkoman dhe nuk mund të kujdeset as ai për vajzën. Për këtë arsye vajza e mitur L.E. mbetet në kujdesin e gjyshit të saj. Gjykata solli vendim për heqjen e të drejtës prindore ndaj prindërve Z.H. dhe E.E.⁷⁶

g) Shkelja e të drejtave të fëmijës në çfarëdo mënyre tjetër

Pasi që në praktikë ndodhin raste të cilat ligji nuk ka mundur që t'i parasheh, ekziston mundësia që edhe për raste tjera gjykata të vendos për heqjen e të drejtës prindore, në ato raste kur e shoh të arsyeshme dhe me ndihmën e qendrës për punë sociale vendosin që sjelljet apo veprimet e prindërve nuk janë në interes të fëmijëve.

Për mbrojtjen e fëmijëve Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve, në nenin 19 thotë: “Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatëshme legislative administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerjes ose keqtrajtimi, braktisjes apo mospërfilljes, nëpërkëmbjes ose shfrytëzimit, duke përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën rruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.”

Gjithashtu, neni 36 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës thotë: “Shtetet palë mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër e shfrytëzimit, që dëmton mirëqënien e tij në çfarëdo aspekti.”

⁷⁶ Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Shkup, viti 2009.

7.2 Pasqyra historike për heqjen e të drejtës prindore në të drejtën Romake

Në të drejtën romake nuk njihet e drejta prindore si përmbledhje rregullash juridike sipas të cilave edhe ati edhe nëna ishin njëloj të autorizuar dhe në mënyrë të njëjtë të detyruar që të kujdeseshin për ngritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Prandaj, në familjen romake u krijua pushteti i *pater familias*, si ndaj personave që lindnin si pasojë natyrore e ekzistimit të martesës, ashtu edhe ndaj personave që me vullnetin e *pater familias* ishin inkadruar si anëtarë të lirë në familje. Përmbledhja e rregullave juridike që e siguronin pushtetin e *pater familias* mbi personat *alieni juris* përbënte të drejtën prindore romake.⁷⁷

Pra e drejta Romake e familjes bazohej në konceptin se çdo familje kishte një *paterfamilias* - kreu i familjes, i cili ishte *sui juris*, që domethënë se ishte ligjërisht i pavarur, pra ai nuk mund të ishte nën pushtetin e dikujt tjetër por i kishte nën pushtet anëtarët e tjerë të familjes.⁷⁸

Pater në të drejtën romake ishte prindi (i ati) si dhe paraardhësit e tij. Bëhej dallimi mes *pater naturalis* dhe *paterfamilias*. *Pater naturalis* ishte prindi (i ati) në kuptimin e ngushtë, ndërsa *paterfamilias* ishte titullari i *patria potestas* që mund të ishte edhe paraardhës i ndryshëm nga babai natyror i fëmijës.⁷⁹

Fili ose *liberi* në të drejtën romake ishin pasardhësit e çfarëdo shkalle. Dalloheshin tre kategori të *filit*: fëmijët legjitim, *spirii* apo fëmijët që lindnin nga një bashkim jo legjitim, si dhe *liberi naturalis* apo të lindurit prej raportit të një të pamartuari me një konkubinë.⁸⁰

Në kohën më të lashtë për krijimin e *patriae potestatis* mbi fëmijën e posalindur kërkoheshin dy kushte: që fëmija të ketë lindur nga ngruaja e cila ishte e martuar me *paterfamiliasin* ose me ndonjë nga anëtarët meshkuj të *domusit* të tij, si dhe që *paterfamilias* të pranonte fëmijën e lindur brenda domusit të tij si anëtar i familjes. Në të kundërtën, fëmija mund të hidhej poshtë, pra të humbiste.⁸¹

Në të drejtën romake, ati kishte pushtetin e plotë mbi të birin dhe jetën e tij. Ai kishte të drejtë ta dërgonte të birin në burg, ta rrihte duke e mbajtur të lidhur, t'i impononte punë bujqësore, si dhe ta vriste. Gjithashtu, të atit i lejohej që ta shiste të birin dhe t'ia merrte të gjitha ato që i kishte fituar. Fëmija apo personi *alieni juris* nuk kishte asnjë të drejtë ndaj *paterfamiliasit*. Mes pozitës së fëmijës dhe pozitës së skllëvërve nuk kishte asnjë dallim.⁸²

⁷⁷ Puhan Ivo, E drejta romake, 1968 Prishtinë, faqe 191

⁷⁸ Borkowski Andrew, dhe Du Plessis Paul, E drejta romake, 2004 Tiranë, faqe 165

⁷⁹ Mandro Arta, E drejta romake, 2007 Tiranë, faqe 199

⁸⁰ Po aty, faqe 199

⁸¹ Puhan Ivo, Vepër e cituar, faqe 192

⁸² Po aty, faqe 194

Fëmijët jolegjitim lindin si persona *sui juris*, të cilët me të ëmën ishin vetëm në gjini cognate, sepse e ëma nuk kishte të drejtë që të vendoste për ta pushtetin prindëror. Pozita e fëmijëve jolegjitim filloi të rregullohej në të drejtën klasike dhe postklasike, ku fituan të drejtën për ushqim nga e ëma dhe të afërmit e saj. Mirëpo, hetimi i atësisë ende nuk ishte i lejuar. Kur ishte fjala për *liberi naturales* të lindur në *konkubinat* mund të siguronin ushqimin edhe nga pasuria e të atit, si dhe mund të siguronin pjesën e trashëgimit kur ati natyror nuk kishte pasardhës legjitimë. Pos kësaj, fëmijët e lindur në *konkubinat* kishin mundësi që edhe të legjitimoheshin.⁸³

Pozita jo e favorshme e personave *alieni juris* filloi të përmirësohet në kohën e ndarjes së familjes romake në *familia rustica* si dhe *familia urbana*. Në fillim të së drejtës postklasike i ati e humbi të drejtë ta hidhte poshtë dhe ta vriste fëmijën e tij, në të kundërtën dënohej ashpër. Pëlqimi i tij për martesë nuk ishte më i domosdoshëm. Pra, prej atëherë i ati dhe fëmija kishin të drejta dhe detyra reciproke. Fëmijët kishin të drejtë të edukoheshin, të merrnin *pajë*, të kërkonin shpalljen e atit batakçi, si dhe të merrnin trashëgimin pas vdekjes së tij. Në të drejtë postklasike u dallua edhe pozita e nënës. Në të drejtën e Justinianit, në marrëdhëniet ndaj fëmijës, nëna ishte pothuaj se e barazuar me të atin. E drejta atënore evoluoi deri sa dolën format e para të së drejtës prindore.⁸⁴

Pra, për shkak të pozitës së vështirë të personave *alieni juris*, ligjdhënësi prej në kohën e nxjerrjes së Ligjit të XII tabelave, të drejtën e *pater familiasit* që ta shesë fëmijën e kufizoi me anë të dispozitës së dytë të tabelës IV, ku sipas kësaj dispozite djali lirohej nga *patria potestas* i *pater familiasit* nëse nga babai i tij shitej tre herë.⁸⁵

Në të drejtën e lashtë fëmijëve nuk u njëhej zotësia pronësore. Atyre u njoh e drejta e trashëgimit të domosdoshëm. Më vonë, për shkak të zhvillimit të vullshëm të ekonomik, personave *alieni juris* iu mundësua që të merrnin pjesë në jetën ekonomike. Fëmijët morën të drejtën e pronës dhe administrimit të pasurisë së fituar nga shërbimi ushtarak ose ai publik, si dhe të drejtën e pronës mbi çdo gjë të fituar, përveç gjërave të fituara nga i ati ose paraardhësit e tij.⁸⁶

Pushteti i *pater familiasit* mund të pushonte në disa mënyra:

- a) Vdekja fizike e personave *alieni juris* shuante çdoherë pushtetin atëror, ndërsa vdekja fizike e *pater familiasit* shuante pushtetin atëror vetëm mbi personat që me *pater familiasin* ishin në gjini në shkallë të parë, pra fëmijët e tij, të cilët bëheshin persona *sui*

⁸³ Dhima Ken, E drejta romake, 2007 Tiranë, faqe 458

⁸⁴ Puhan Ivo, Vepër e cituar, faqe 194

⁸⁵ Halimi Musli, Marrëdhëniet juridiko- civile në Ligjin e XII tabelave, 2006 Tetovë, faqe

⁸⁶ Mandro Arta, Vepër e cituar, faqe 207

juris dhe kryetarë të familjeve të tjera. Ndërsa të afërmit e shkallëve më të largëta e ndërronin *pater familiasin*.

- b) Emancipimi ose çlirimi nga pushteti atëror me vullnetin e *pater familiasit*, ishte rasti më i shpeshtë i shuarjes së pushtetit atëror. Fillimisht personi i emancipuar ngelte pa përkrahje familjare. Pastaj, në të drejtën postklasike, emancipimi bëhej me deklarin e *pater familiasit* përpara organit kompetent. Justiniani përcaktoi që emancipimi ligjor të bëhej edhe në rastet kur personat *alieni juris* fitonin pozita të larta shtetërore dhe kjo gjë realizohej me dokument përpara magjistratit.
- c) Pushteti atëror mund të shuhej edhe kur i ati nuk ishte i denjë.
- d) Pushteti atëror shuhej kur i ati humbiste qytetarinë romake, kur binte në skllavëri. Në këto raste fëmijët bëheshin *sui juris*. Ndërsa në rastet kur i ati është zënë rob, pushteti atëror pezullohet dhe rifitohet në qoftë se kthehet nga robëria.
- e) Pushteti atëror shuhet në qoftëse i ati adrogohet ose e jep të birin në birësim, vajzën *in manum* dhe djalë *in mancipum*.⁸⁷

⁸⁷ Mandro Arta, Vepër e cituar, faqe 211

7.3 Pasqyra historike për heqjen e të drejtës prindore në të drejtën zakonore shqiptare

Shqiptarët kishin dëshirë që të kenë fëmijë, sidomos djem. Gruaja e cila lindte djem ishte më e nderuar në familje nga ajo që lindte vetëm vajza. Vajzat shiheshin si barrë për familjen. Mirëpo, prindërit i donin si demtë ashtu edhe vajzat. Për këtë ka shkruajtur edhe studiuesi austriak F. Nopça i cili e kishte vizituar Shqipërinë e Veriut disa herë në fillim të shekullit XX: “Shqipëtarët i duan shumë fëmijët e janë pothuajse skllevër të tyre”.⁸⁸

Sipas të drejtës zakonore shqipëtare, e drejta prindore i takonte babait. Mirëpo, edhe nëna kishte të drejta dhe detyra, pos pushtetit prindëror, i cili i përkiste vetëm të atit. Prindërit kishin si detyrë kryesore rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Ato ishin të interesuar të risnin fëmijët me virtytet më të mira të asaj kohe, të ishin të ndershëm, punëtorë, trima, të ishin të besës, të mençur, mikpritës, lirishtës, etj.⁸⁹

Pozita sunduese e babait shprehej në të drejtën e tij për të urdhëruar fëmijët e tij që të kryenin detyra të ndryshme në familje dhe jashtë saj. Babai gjithashtu kishte të drejtë të vendoste mbi fitimet e të birit, të cilat fitime i bashkoheshin ekonomisë së përbashkët të familjes dhe ai nuk kishte të drejtë të kundërshtonte. Në të kundërtën, për kundërshtimin e fëmijëve, babai merrte masa ndëshkuese si qortimi, rrahja, burgosja në shtëpi, si dhe kishte të drejtën e jetës dhe vdekjes mbi fëmijët e tij.⁹⁰

Pra, sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit babai kishte të drejtë:

- Mbi jetën e fëmijëve;
- Ta rrahë, ta lidhë, ta burgosë dhe ta vrasë fëmijën e tij dhe kanuni për këtë nuk i kërkonte arsye;
- Ta detyrojë fëmijën që të punojë;
- Të drejtë mbi fitimet e të birit;
- Të mos jetë nën sundim të birit deri sa të jetë gjallë, e pasi të vdes i biri do të ishte trashëgimtarë.⁹¹

Pushteti i babait ndaj fëmijës në të drejtën zakonore shqipëtare ishte i ngjashëm me atë në të drejtën e lashtë romake. Ky pushtet dallonte në atë se, në të drejtën romake i ati e kishte

⁸⁸ Luarasi Aleks, Studime për të drejtën zakonore shqiptare-Marrëdhëniet familjare, 2007 Tiranë, faqe 159

⁸⁹ Po aty, faqe 160

⁹⁰ Luarasi Aleks, Studime Vepër e cituar, faqe 161

⁹¹ Gjeçovi Shtjefen, Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1999 Tiranë, faqe 21

pushtetin mbi fëmijët e tij si dhe mbi anëtarët e tjerë të familjes, ndërsa në të dretën zakonore shqipëtare i ati kishte pushtet vetëm mbi fëmijët e tij.⁹²

Në të drejtën zakonore shqipëtare, i ati kishte për detyrë që të punonte për të mirën e shtëpisë, t'i martonte djemtë dhe vajzat, të kujdesej që pas vdekjes së tij të mos u linte borxhe djemve dhe pasurinë ta ndante ndërmjet bijëve. E drejta zakonore shqipëtare dallonte me atë se babai përgjigjej për veprat penale të kryera nga djemtë e tij, sepse sipas tyre rreziku i kësaj vepre do t'u përpjestohej vëllezërve të tij.⁹³

Nëna sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit nuk kishte fare të drejta mbi fëmijët e vet. Ndërsa, sipas Kanunit të Lumës, nëna kishte për detyrë që të kujdesej për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, bashkarisht me të shoqin të mendonte për martesën e fëmijëve, arkën e vet t'ua lente trashëgim fëmijëve, t'i priste e përcillte në shtrojën e vet vajzat e martuara, etj. Mirëpo, edhe sipas këtij kanuni fëmijët ishin të babait, ajo nuk mund t'i qortonte, t'i rrihte dhe t'i lidhte fëmijët e vet. Për sjelljet e papëlqyera të fëmijëve, nëna kishte të drejtë ta njoftonte të shoqin. Ajo nuk kishte të drejtë t'i vriste fëmijët pasi ata i përkisnin burrit të saj dhe fisit të tij.⁹⁴

Fëmijët kishin detyrime ndaj babait të tyre si prind dhe duhej t'i rrinin nën sundim. Shkalla e lirisë dhe e vetëveprimit të tyre ishte e kufizuar. Djemtë nuk kishin të drejtë të blenin, shisnin apo të dhuronin diçka pa lejen e babait. Në moshën 15 vjeçare kishin të drejtë të mbajnë armë të cilën ua siguronte babai. Ata nuk mund të punonin pa lejen e babait si dhe nuk mund të shkonin askund pa lejen e tij. Fëmijët do të martoheshin atje ku vendoste i ati.⁹⁵

⁹² Luarasi Aleks, Studime Vepër e cituar, faqe 162

⁹³ Po aty, faqe 163

⁹⁴ Po aty, faqe 164

⁹⁵ Luarasi Aleks, Studime Vepër e cituar, faqe 164

KAPITULLI I TRETË

PROCEDURA PËR HEQJEN E TË DREJTËS PRINDORE

1. Objekti i procedurës

Me lindjen e fëmijëve, krijohen edhe marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve. Këto marrëdhënie krijohen në të drejta dhe detyrime të prindërve që të kujdesen për ruajtjen, edukimin dhe shkollimin e fëmijëve të tyre. Pra, të drejtë prindore e përbëjnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve që të kujdesen për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre, si ndaj fëmijëve të mitur, po ashtu edhe ndaj atyre ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindore. Mirëpo, ndodh në praktikë që prindërit gjatë ushtrimit të së drejtës prindore të udhëhiqen nga nevoja dhe interesa të tjera dhe t'i shmangen ushtrimit të kësaj të drejte. Në këto raste prindit mund t'i hiqet e drejta prindore në bazë të kushteve të parashikuara me ligj.

96

E drejta prindore i hiqet prindit në procedurë të veçantë jashtë kontestimore pasi gjykata të ketë marrë mendimin e Qendrës për punë sociale, si institut i cili merret me mbikqyrjen e ushtrimit të së drejtës prindore. Fillimisht, gjykata vërteton në qoftëse ekzistojnë arsye që prindit t'i hiqet e drejta prindore. Pas kësaj, me heqjen e kësaj të drejte nënkuptohet caktimi i prindit që të ketë pozitën e kujdestarit, e cila nënkupton që prindit i kufizohet e drejta që të administrojë me pasuritë e paluajtëshme të fëmijëve, që do të thotë se prindi nuk ka të drejtë pa pëlqimin e Qendrës për punë sociale të merr vendime lidhur me pasuritë e paluajtëshme të fëmijëve.⁹⁷

⁹⁶ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, E drejta procedural civile (Libri i dytë – E drejta jokontestimore), 2010 Shkup, faqe 102

⁹⁷ Po aty, faqe 103

2. Kompetenca vendore e gjykatave

Vendimin për heqjen e të drejtës prindore e merr gjykata komunale në procedurë jashtëkontestimore, për shkaqet e shprehura në dispozitat ligjore.⁹⁸

Kompetenca vendore e gjykatave është përcaktuar si *forum electivum*: për heqjen e të drejtës prindore si dhe për kthimin e saj, kompetente është gjykata në rajonin e së cilës e ka vendbanimin personi ndaj të cilit është hapur procedura, ose gjykata në rajonin e së cilës fëmija e ka vendbanimin apo vendqëndrimin.⁹⁹

Kështu thot edhe Ligji për procedurë jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë në nenin 106, ku gjithashtu thuhet se: “Procedurën e përfundon gjykata e cila e para e ka ngritur procedurën.”

Është paraparë se edhe gjykata e cila është duke e zhvilluar procedurën e veçantë kontestimore për zgjidhjen e kontestit martesorë apo kontestit lidhur me raportin mes prindit dhe fëmijës, *ex officio* merr vendimin me të cilin prindin e privon nga e drejta prindore.¹⁰⁰

3. Inicimi i procedurës

Sipas ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë, nenit 91: “Procedurë për heqjen e të drejtës prindore mund të inicojë prindi tjetër, Qendra për punë sociale ose prokurori publik”.

Prokurori ka të drejtë: të kërkojë ndryshimin e kushteve të ushtrimit të së drejtës prindore; të kërkojë heqjen e të drejtës prindore atëherë kur prindi nuk e ushtron ashtu siç duhet të drejtën prindore apo tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, apo me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve; të kërkojë pavlefshmërinë e veprimit juridik që është marrë pa lejen e gjykatës. *Të afërmit* kanë të drejtë të kërkojnë heqjen e të

⁹⁸ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 198

⁹⁹ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 104

¹⁰⁰ Brestovci Faik, E drejta procedural civile II, 1997 Prishtinë, faqe 130

drejtës prindore kur prindi keqpërdor ushtrimin e të drejtës prindore, apo tregon pakujdesi, apo me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijës.¹⁰¹

Sa i përket të drejtës për inicimin e procedurës për heqjen e së drejtës prindore, gjegjësisht të drejtës për padi, do të përdor si shembull një rast nga praktika gjyqësore në Shqipëri:

Fëmija F.H. i lindur më 25.10.1996, është birësuar prej shtetases H.P. sipas vendimit gjyqësor civil më date 12.04.2001, i marrë nga çifti H.P. dhe B.P. që kur ishte dy muajsh. Bashkëshorti i H.P. vdes dhe ajo fillon vet procedurat e birësimit , mirëpo pas një kohe ajo fillon të tregojë mungesë kujdesi dhe vëmendje ndaj fëmijës, e le të vetëm me orë të tëra dhe krijon situatë të pakëndëshme. Në ndërkohë është njoftuar me G.J. një shtetas i huaj dhe dëshiron të lidhë martesë me të. Prindërit biologjik janë informuar për të gjithë situatën dhe kanë marrë fëmijën në shtëpinë e tyre. Në ndërkohë kanë kërkuar nga gjykata heqjen e të drejtës prindore prej nënës birësuese H.P. Në këtë rast prindërit biologjik në cilësinë e paditësit, i provuan gjykatës se nëna birësuese e ka braktisur fëmijën dhe fëmija vazhdon shkollimin pranë tyre.¹⁰²

Organi i kujdestarisë pos paraqitjes së propozimit, për heqjen e të drejtës prindore, në raste të caktuara ka për detyrë që në mënyrë urgjente të marrë masa për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesit të fëmijës.¹⁰³

4. Zhvillimi i procedurës

Procedura për heqjen e të drejtës prindore është procedurë urgjente. Gjykata ka për detyrë t'i marrë të gjitha provat relevante për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.¹⁰⁴

Gjykata, pavarësisht se a flitet për heqjen e të drejtës prindore ose për kthimin e saj, është e detyruar të merr mendim nga Qendra për punë sociale në rast se procedura nuk është

¹⁰¹ Mandro-Bilalli Arta, Vepër e cituar, faqe 438

¹⁰² Po aty, faqe 438

¹⁰³ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 144

¹⁰⁴ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 198

inicuar nga ajo. Mendimi i Qendrës për punë sociale ka rëndësi pasi që ky institut e bën mbikqyrjen e ushtrimit të së drejtës prindore.¹⁰⁵

Qendra për punë sociale, në qytetin e Gostivarit, në 5 vitet e fundit ka shqyrtuar 5 raste për heqjen e të drejtës prindore dhe në të gjitha këto raste është hequr e drejta prindore. Sipas praktikës, arsyet më të shpeshta për shkak të së cilave bëhet heqja e të drejtës prindore, janë braktisja e fëmijëve, si dhe shkelja e rëndë e kësaj të drejte.

Nga të dhënat e qendrës për punë sociale, nga 5 rastet e 5 viteve të fundit, në 3 prej tyre e drejta prindore i është hequr nënës, ndërsa në 2 prej tyre i është hequr të atit. Pas heqjes së të drejtës prindore, fëmijët janë vendosur nën kujdestari.

Qendra për punë sociale në Gostivar, gjithashtu konfirmoi se në 5 vitet e fundit, nuk ka pasur raste ku e drejta prindore u është hequr që të dy prindërve.

Gjatë zhvillimit të procedurës për heqjen e të drejtës prindore, do të bëhet edhe dëgjimi i palëve pjesëmarrëse në procedurë. Për këtë flet edhe neni 109 i ligjit për procedurë jashtëkontestimore të Republikës së Maqedonisë, ku thotë: “Në procedurën për marrjen e kryerjes së të drejtave prindore dhe kthimin e të drejtave prindore, gjykata do t’i dëgjojë propozuesin, prindin ndaj të cilit udhëhiqet procedura nëse kjo është e mundur, prindin ndaj të cilit nuk mbahet procedura nëse nuk është propozues dhe personat e tjerë që mund të japin njoftime të duhura.”

Gjatë zhvillimit të procedurës, për të drejtë e fëmijës që të dëgjohet flet edhe Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës, në nenin 12: “Fëmijës i jepet veçanërisht mundësia që të dëgjohet në çdo procedure gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtëpërsëdrejti, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, sipas mënyrës që është në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.”

Gjithashtu neni 13 i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës, shkruan: “Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes, kjo e drejtë përfshin larine për të kërkuar, për të marrë dhe për të

¹⁰⁵ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe ?

përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kufijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose në formë artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.”

Vendimi merret në bazë të shqyrtimit në seancën gjyqësore, ku si pjesëmarrës thirren: organi i kujdestarisë, prindërit, si dhe kujdestari (në rastet ku është emëruar). Fëmija mund të thirret në seancë nëse është më i vjetër se 10 vjeç dhe nëse gjykata mendon se kjo do të jetë e nevojshme, pasi ka marrë medimin nga organi i kujdestarisë. Gjatë procedurës, fëmija dëgjohet vetëm atëherë kur një gjë e tillë është e domosdoshme për konstatimin e fakteve relevante dhe kjo nuk do të jetë në dëm të gjendjes psiqike të fëmijës.¹⁰⁶

Në procedurën e provave, gjykata duhet t’i hetojë dhe t’i shqyrtojë të gjitha rrethanat relevante në secilin rast konkret. Gjkata mund të vendos që propozimin për heqjen e të drejtës prindore ta refuzojë ose ta miratojë.¹⁰⁷

5. Aktvendimi

Prindërve u hiqet e drejta prindore me vendim të gjykatës, për kohë të pacaktuar. Mirëpo, aktvendimi humb efektet e veta juridike në momentin kur fëmija arrin moshën madhore ose me emancipim.¹⁰⁸

Në aktvendimin për heqjen e të drejtës prindore përckatohen të drejtat të cilat prindi nuk do të mund që t’i ushtrojë ndaj fëmijës dhe këto të drejta do t’i ushtrojë prindi tjetër. Mirëpo, nëse edhe prindit tjetër i është hequr e drejta prindore, ka vdekur, nuk njihet, ose për arsye të tjera i janë kufizuar të drejtat prindore, atëherë Qendra për punë sociale do t’i caktojë fëmijës kujdestarë.¹⁰⁹

Prindit mund t’i hiqet e drejta prindore për të gjithë fëmijët ose vetëm për një fëmijë të caktuar, varësisht se si ai e ka ushtruar të drejtë prindore ndaj fëmijëve, ose thënë më ndryshe, varësisht se ndaj cilit fëmijë e ka keqpërdorur ushtrimin e të drejtës prindore.

¹⁰⁶ Brestovci Faik, Vepër e cituar, faqe 130

¹⁰⁷ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 144

¹⁰⁸ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 198

¹⁰⁹ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 105

Aktvendimin mbi heqjen e të drejtës prindore gjykata duhet që t’ia dorëzojë ofiqarit kompetent pasi që duhet të regjistrohet në librin amë të të lindurve. Nëse fëmija ka pasuri të paluajtëshme, kjo pasuri duhet të evidentohet në regjistrin për pasuritë e paluajtëshme.

6. Natyra juridike dhe efekti i vendimit

Aktvendimi mbi heqjen e të drejtës prindore, aktvendimi mbi përcaktimin e prindit në pozitën e kujdestarit si dhe aktvendimi mbi kthimin e të drejtës prindore, ka natyrë juridike konstitutive. Kjo për arsye se pasi të merret aktvendimi lindin të drejta të rreja lidhur me marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve. Aktvendimi për heqjen e së drejtës prindore do të ketë efekt jo vetëm për prindin të cilit i është hequr e drejta prindore por edhe për fëmijën dhe prindin tjetër.¹¹⁰

7. Mjetet juridike

Kundër vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet propozimi për heqjen e të drejtës prindore, lejohet ankesë e posaçme. Ankesa e paraqitur nuk prodhon efekt suspensiv, vetëm nëse gjykata në këtë rast nuk do të veprojë ndryshe.¹¹¹

Të drejtë për të paraqitur ankesë kanë: prindi ndaj të cilit është parashtruar padia; prindi tjetër; si dhe Qendra për punë sociale nëse me propozimin e tyre është ngritur procedura. Pasi aktvendimi për heqjen e të drejtës prindore bëhet i plotëfuqishëm, nuk lejohen mjetet e revizionit.¹¹²

¹¹⁰ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 106

¹¹¹ Brestovci Faik, Vepër e cituar, faqe 130

¹¹² Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 106

8. Shpenzimet në procedurë

Shpenzimet të cilat bëhen gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore për heqjen e të drejtës prindore, i mbulon pala në interes të së cilës është hapur procedura.

9. Pasojat e heqjes së të drejtës prindore

Heqja e të drejtës prindore është dënimi më i rëndë që mund t'i shqiptohet prindit.

Me heqjen e të drejtës prindore, prindi nuk mund t'i ushtrojë të drejtat lidhur me mbajtjen, mirërritjen, edukimin, shkollimin dhe administrimin e pasurisë së fëmijës. Më shpesh ndodh që fëmijët të vihen nën kujdestari por mund t'u besohen për ruajtje dhe edukim edhe personave të tretë. Pas heqjes së të drejtës prindore, prindit i ngelet vetëm një detyrë, e ajo është ushqimi i detyruar ndaj fëmijës. Gjithashtu, prindi për detyrë ka t'i përmbush shpenzimet lidhur me mbajtjen dhe mirërritjen, edukimin dhe shkollimin, atëherë kur fëmijët i besohen për ruajtje një personi të tretë.¹¹³

10. Përcaktimi i prindërve në pozitën e kujdestarit

Me aktvendimin me të cilin prindi përcaktohet të ketë pozitën e kujdestarit, prindit i kufizohen të drejtat sa i përket administrimit të pasurisë së fëmijës. Prindi që ka pozitën e kujdestarit duhet që të merr leje nga Qendra për punë sociale për veprimet që do t'i ndërmer lidhur me administrimin e pasurisë së fëmijës.¹¹⁴

11. Kthimi i të drejtës prindore

Kthimi i të drejtës prindore bëhet atëherë kur pushojnë shkaqet për të cilat ka ardhur deri te heqja e saj. Kërkesën për kthimin e të drejtës prindore mund ta parashtrojnë vetë prindërit ose organi i kujdestarisë. Gjykata mundet që *ex officio* të merr vendimin për rikthimin e kujdesit prindor. Vendimin gjykata e merr në procedurë jashtëkontestimore, në atë mënyrë si

¹¹³ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 198

¹¹⁴ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 105

në rastin e heqjes së të drejtës prindore. Në këtë mënyrë prindërit vazhdojnë edhe më tutje t'i kryejnë detyrat dhe të drejtat e tyre ndaj fëmijëve të tyre.¹¹⁵

Edhe në Rpublikën e Maqedonisë, neni 92 i ligjit për familje thotë: “Me vendim të gjykatës e drejta prindore mund t'i kthehet prindit kur të pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat i është marrë ajo. Propozimin për kthimin e të drejtës prindore mund ta paraqesë prindi apo Qendra për punë sociale”.

Vendimi për kthimin e të drejtës prindore gjykata mund ta merr *ex ofittio* në procedurën e veçantë kontestimore që është duke u zhvilluar për zgjidhjen e kontestit martesorë apo të kontestit lidhur me marrëdhënien mes prindit dhe fëmijës.¹¹⁶

Në procedurën për kthimin e të drejtës prindore zbatohen dispozitat ligjore me të cilat është rregulluar procedura për heqjen e të drejtës prindore. Kjo vlen për çështjet procedurale lidhur me të cilat nuk ka në ligj dispozita të veçanta.¹¹⁷

¹¹⁵ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 198

¹¹⁶ Brestovci Faik, Vepër e cituar, faqe 131

¹¹⁷ Po aty, faqe 131

KAPITULLI I KATËRT

ASPEKTI KRAHASUES I PROCEDURAVE PËR HEQJEN E TË DREJTËS PRINDORE

1. Heqja e të drejtës prindore në Republikën e Kosovës

1.1 Ligji për familje në Republikën e Kosovës

Heqja e të drejtës prindore rregullohet me norma ligjore edhe në Ligjin për familje në Republikën e Kosovës.

Prindërit të cilët e keqpërdorin ushtrimin e të drejtës prindore ose në mënyrë serioze e neglizhon ushtrimin e kësaj të drejte, privohen nga kujdesi prindor, ndaj njërit fëmijë ose ndaj tëgjithëve. Vendimin për privimin e kujdesit prindor e merr gjykata kompetente në procedure jashtëkontestimore, pasi të merr mendimin nga organi i kujdestarisë si dhe pasi të ketë hetuar rrethanat e nevojshme lidhur me rastin konkret.¹¹⁸

Sa i përket procedurës për heqjen e të drejtës prindore në Republikën e Kosovës, neni 150 i ligjit për familje thotë: “Vendimi për privimin e kujdesit prindor mund të inicohet nga prindi tjetër, organi i kujdestarisë ose gjykata. Organi i kujdestarisë është i detyruar të fillojë procedurën për privimin e kujdesit prindor nëse meson për ekzistimin e shkaqeve të ofruara në këtë ligj.”

1.2 Komparacioni në mes ligjit për familje në Republikën e Kosovës dhe të Maqedonisë sa i përket heqjes së të drejtës prindore

Heqja e të drejtës prindore sipas ligjit për familje në Republikën e Kosovës dhe sipas ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë ka shumë ngjashmëri.

¹¹⁸ Neni 149, Ligji për familje në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.32/2004

Si në Republikën e Kosovës ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë shkaqet për të cilat bëhet heqja e të drejtës prindore janë të njejta, e ato janë keqpërdorimi i ushtrimit të së drejtës prindore si dhe anashkalimi i rëndë i ushtrimit të detyrave prindore.

Dallim në mes të ligjit për familje në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë mund të vërejmë sa i përket inicimit të procedurës për heqjen e të drejtës prindore. Në Republikën e Kosovës iniciimin e procedurës për heqjen e të drejtës prindore e bën prindi tjetër, organi i kujdestarisë ose gjykata, ndërsa në Republikën e Maqedonisë iniciimin e procedurës për heqjen e të drejtës prindore e bën prindi tjetër, qendra për punë sociale ose prokurori publik.

2. Heqja e të drejtës prindore në Republikën e Shqipërisë

2.1 Kodi për familje në republikën e Shqipërisë

Heqja e të drejtës prindore është e rregulluar edhe në Kodin e familjes të Shqipërisë. Neni 228 i këtij Kodi sa i përket heqjes së të drejtës prindore thotë: “Kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmeve të fëmijës ose të prokurorit, mund t’i hiqet përgjegjësia prindore. Heqja e përgjegjësisë prindore bëhet me vendim të gjykatës, duke u thirrur si i paditur prindi, për të cilin kërkohet kjo heqje.”

Gjykata do të vendosë nëse heqja e të drejtës prindore do të shtrihet mbi të gjithë fëmijët apo vetëm mbi njërin fëmijë. Heqja e të drejtës prindore e shkarkon fëmijën nga detyrimi për ushqim ndaj prindërve, përveç në rastet kur gjykata do të vendosë ndryshe.¹¹⁹

2.2 Komparacioni në mes Kodit për familje në Republikën e Shqipërisë dhe të ligjit për familje në Republikën Maqedonisë sa i përket heqjes së të drejtës prindore

Heqja e të drejtës prindore është e rregulluar në mënyrë shumë të ngjashme si në Kodin e familjes së Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe në ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë.

Dallimin mes tyre qëndron tek iniciimi i procedurës për heqjen e të drejtës prindore. Sipas Kodit për familje të Republikës së Shqipërisë iniciimin e procedurës mund ta bëjë prindi tjetër, të afërmit e fëmijës, ose prokurori, ndërsa sipas ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë iniciimin e procedurës për heqjen e të drejtës prindore siç e kemi thënë edhe më herët, mund ta bëjë prindi tjetër, qendra për punë sociale, ose prokurori publik.

¹¹⁹ Neni 229, Kodi i familjes, Republika e Shqipërisë, Ligji Nr.9062, 2003

3. Heqja e të drejtës prindore në Republikën e Sërbisë

3.1 Ligji për familje në Republikën e Sërbisë

Edhe Republika e Sërbisë e ka të rregulluar me ligj heqjen e të drejtës prindore.

E drejta prindore do t'i hiqet prindit i cili e keqpërdor të drejtën prindore apo i shpërfill jashtë mase detyrat në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindore. Prindi i keqpërdor të drejtat prindore atëherë kur: e abuzon fëmijën fizikisht, seksualisht ose emocionalisht; e detyron fëmijën të punojë punë të rënda, apo punë që e kërcënojnë moralin, shëndetin apo edukimin e fëmijës, ose punë të tjera të cilat janë të ndaluara me ligj; e inkurajon fëmijën që të kryejë veprime penale; e përdor fëmijën për punë të këqija; si dhe në mënyra të tjera i keqpërdor të drejtat dhe detyrat prindore. Ndërsa, prindi i shpërfill jashtë mase detyrat në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindore atëherë kur: e braktis fëmijën; kur nuk kujdeset aspak për fëmijën me të cilin jeton; kur i shmanget mbajtjes së fëmijës apo kur nuk mban marrëdhënie personale me fëmijën me të cilin nuk jeton bashkë, përkatësisht i shmanget kontakteve me fëmijën me të cilin nuk jeton bashkë; kur me qëllim nuk krijon kushte që të jetojë bashkë me fëmijën i cili jeton në një institucion të mbrojtjes sociale; si dhe kur në ndonjë mënyrë tjetër e neglizhon rëndë ushtrimin e detyrave prindore.¹²⁰

Gjykata me vendimin për heqjen e të drejtës prindore, prindit do t'ia heq të gjitha të drejtat dhe detyrat prindore, përveç detyrës për ta mbajtur fëmijën. Me vendimin për heqjen e të drejtës prindore, gjykata mund të merr një ose më tepër masa për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna në familje.¹²¹

3.2 Komparacioni në mes ligjit për familje në Republikën e Sërbisë dhe të Maqedonisë sa i përket heqjes së të drejtës prindore

Edhe ligji për familje në Republikën e Sërbisë e rregullon në mënyrë të ngjashme heqjen e të drejtës prindore, ashtu si ligji për familje në Republikën e Maqedonisë. Për dallim nga ligji

¹²⁰Neni 81, Porodicni zakon, Sluzbenom Glasniku, Republika Srpska, 18/2005

¹²¹ Po aty, Neni 81

për familje në Republikën e Maqedonisë, ligji i Republikës së Sërbisë e parashikon edhe heqjen e pjesërishme të së drejtës prindore. Për këtë shkruan neni 82: “Prindi i cili me pakujdesi ushtron të drejtat dhe detyrat prindore, mund të privohet pjesërisht nga e drejta prindore.”

PËRFUNDIMI DHE KONKLuzioni

Mund të duket jo reale që prindi ti shkaktojë dëm fëmijës së tij, mirëpo fatkeqsisht në jetën e përditëshme ndodhin raste nga më të ndryshmet ku prindërit i keqtrajtojnë, abuzojnë e ushtrojnë dhunë ndaj fëmijëve të tyre.

Në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë janë të parapara ligjet që i rregullojnë këto marrëdhënie, ashtu siç e pamë deri tani, mirëpo çdoherë ekzistojnë mangësi.

Në praktikë dëgjojmë raste ku për shkak të shkurorëzimit të martesës, prindërit nuk e ushtrojnë të drejtën prindore si duhet dhe kjo gjë reflekton keq tek fëmijët, ndikon negativisht në psikologjinë e fëmijës. Edhe pas shkurorëzimit të martesës fëmija ka nevojë për të dy prindërit, për prezencën dhe kujdesin e tyre. Edhe pse pas shkurorëzimit fëmija i besohet njërit prind, kjo nuk do të thotë se prindi tjetër duhet të largohet nga jeta e fëmijut.

Vlen të theksohet se në vendin tonë fatkeqësisht nuk është rritur vetëdijësimi tek disa prindër se për keqpërdorimin e të drejtës prindore, duhet medoemos të merren masat e duhura.

Në praktikën gjyqësore mund të gjejmë vetëm pak raste ku janë ndërmarë veprime ligjore për një shkelje të tillë, siç është shkelja e të drejtës prindore. Kjo për arsye se shkeljet e tilla nuk lajmërohen.

Me keqardhje them se edhe pse ligji i mbron fëmijët dhe të drejtat e tyre, ata nuk mund që t'i gëzojnë këto të drejta në të shumtën e rasteve për shkak të rasteve të përmendura më lartë, apo edhe për shkak edhe të shumë rasteve të cilat ende nuk i kemi parashikuar.

Pasi studiova dhe hulumtova në këtë drejtim, pash që nuk mjaftojnë vetëm ligjet për tu mbrojtur të drejtat e fëmijëve, mungojnë veprimet e prindërve, vullneti i tyre, institutet e ndryshme që do të kujdesen për fëmijët me problem të tilla, iniciativa më e madhe e Qendrës për Punë Sociale që t'i hetojë më tepër rastet e tilla, si dhe shumë faktorë të tjerë.

Andaj, duhet punuar sa më shumë në këtë drejtim, që fëmijët të kenë një jetë sa më të shëndoshë familjare e të lumtur, pasi fëmijët janë ardhmëria jonë!

BIBLIOGRAFIA

Tekste, monografi, artikuj

1. Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007
2. Alinčić Mira, Hrabar Dubravka, Jakovac-Lozic Dijana i Korac Aleksandra, Obiteljsko pravo, Zagreb, 2006
3. Al-Marzouqi Ibrahim Abdulla, Human rights in Islamic Law, Abu Dhabi, 2000
4. Brestovci Faik, E drejta procedural civile II, Prishtinë, 1997
5. Borkowski Andrew & Du Plessis Paul, E drejta romake, Tiranë, 2004
6. Draskić Marija, Porodično pravo i pravo deteta, Beograd, 2007
7. Dhima Ken, E drejta romake, Tiranë, 2007
8. Gjeçovi Shtjefen, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë, 1999
9. Halimi Musli, Marrëdhëniet juridiko- civile në Ligjin e XII tabelave, Tetovë, 2006
10. Хаџивасилев Миле, Семејно право, Скопје, 1987
11. Јаневски Арсен и Зороска- Камиловска Татјана, Граѓанско процесно право (Книга втора – Вонпарнично право), Скопје, 2010
12. Јавна установа Завод за социјални дејности, Стручно-Методолошки упатства и прирачници Документи, книга 1, Скопје, 2007
13. Јавна установа Завод за социјални дејности, Истражувања и анализи, книга 2, Скопје, 2007
14. Luarasi Aleks, Studime për të drejtën zakonore shqiptare-Marrëdhëniet familjare, Tiranë, 2007
15. Mandro-Bilalli Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007
16. Mandro-Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tefta dhe Fullani Arjana, E drejta familjare, Tiranë, 2006
17. Mandro Arta, E drejta romake, Tiranë, 2007
18. Oruçi Gani, E drejta familjare, Prishtinë, 1994
19. Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005
20. Puhan Ivo, E drejta romake, Prishtinë, 1968

21. Спировиќ-Трпеновска Љиљана, Семејно право, Скопје, 1997
22. Udhëzues për qytetarët, Për strukturën, ingjerancat dhe shërbimet e Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, Shkup, 2009

Akte ligjore, kode

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
3. Zakon za semejstvoto, Sluzben Vesnik na R.M., Br.67/2010
4. Porodicni zakon, Sluzbenom Glasniku, Republika Srpska, 18/2005
5. Kodi i familjes, Republika e Shqipërisë, Ligji Nr.9062, 2003
6. Ligji për familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.32/2004
7. Zakon za vonparnicna postapka , Sluzben Vesnik na R.M., Br.9/2008
8. Konventa për të drejtat e fëmijëve, 1989
9. Zakon za licnoto ime, Sluzben vesnik na R.M., Br. 08/1995
10. Ligji për marrëdhëniet e punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.54/13

Praktika gjyqësore

1. Të dhëna statistikore nga Gjykata Themelore-Tetovë
2. Të dhëna statistikore nga Qendra për punë Sociale – Gostivar

Burime nga internet

1. <http://zsd.gov.mk>
2. <http://www.idividi.com.mk/shqip/macedoni/908393/index.html>